



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 164

Tiranë – E mërkurë, 29 korrik 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 64/2026, datë 2.7.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8391, datë 28.10.1998, “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, i ndryshuar..... 16645
Dekret i Presidentit nr. 404, datë 23.7.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16646
Dekret i Presidentit nr. 405, datë 23.7.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16646
Dekret i Presidentit nr. 406, datë 23.7.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16647
Dekret i Presidentit nr. 407, datë 23.7.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16647
Dekret i Presidentit nr. 408, datë 23.7.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16647
Dekret i Presidentit nr. 409, datë 23.7.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16647
Dekret i Presidentit nr. 410, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 16648
Dekret i Presidentit nr. 411, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 16648
Dekret i Presidentit nr. 412, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 16648
Dekret i Presidentit nr. 413, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 16649

Dekret i Presidentit nr. 414, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16649
Dekret i Presidentit nr. 415, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16649
Dekret i Presidentit nr. 416, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16650
Dekret i Presidentit nr. 417, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16650
Dekret i Presidentit nr. 418, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16650
Dekret i Presidentit nr. 419, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16650
Dekret i Presidentit nr. 420, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16651
Dekret i Presidentit nr. 421, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16651
Dekret i Presidentit nr. 422, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16651
Dekret i Presidentit nr. 423, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16652
Dekret i Presidentit nr. 424, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16652
Dekret i Presidentit nr. 425, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16652
Dekret i Presidentit nr. 426, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16653
Dekret i Presidentit nr. 427, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16653
Dekret i Presidentit nr. 428, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16653
Dekret i Presidentit nr. 429, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16653
Dekret i Presidentit nr. 430, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16654
Dekret i Presidentit nr. 431, datë 23.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16654

Udhëzim i përbashkët i ministrit të Punëve të Brendshme, i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit dhe i drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit nr. 137, datë 15.7.2026	Për bashkëpunimin ndërmjet strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Shërbimit Informativ të Shtetit, për procedurat e lëshimit të lejes së qëndrimit për të huajt.....	16654
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 162, datë 20.7.2026	Për miratimin e rregullores për kërkesat e përbashkëta të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurave të operimit për shmangien e përplasjeve ajrore.....	16661
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 163, datë 20.7.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 143, datë 18.7.2022, “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilot”	16662
Urdhër i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 305, datë 20.7.2026	Për disa ndryshime në urdhrin nr. 99, datë 25.5.2021, “Për miratimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale”, i ndryshuar....	16665
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 551, datë 17.7.2026	Për delegim kompetence.....	16672
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 741, datë 16.7.2026	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël.....	16673
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 745, datë 17.7.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Kroacisë.....	16674
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 746, datë 17.7.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës.....	16676
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 750, datë 20.7.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar.....	16678
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 751, datë 20.7.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.....	16681
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 181, datë 6.7.2026	Mbi pezullimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.....	16682
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 182, datë 6.7.2026	Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së tregtimit të energjisë elektrike te shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k.....	16685
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 183, datë 6.7.2026	Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së furnizimit të energjisë elektrike te shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k.....	16687

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 184, datë 6.7.2026	Mbi licencimin e shoqërisë “Nexora Energy” sh.p.k. për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.....	16689
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 185, datë 6.7.2026	Mbi fillimin e procedurës administrative për kërkesën e shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH)” sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et lundruese “Tigri 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw dhe “Tigri 3”, me kapacitet të instaluar 60 mw.....	16691
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 186, datë 6.7.2026	Mbi fillimin e procedurës administrative për kërkesën e shoqërisë “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	16693
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 187, datë 6.7.2026	Mbi fillimin e procedurës administrative për kërkesën e shoqërisë “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	16694
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 188, datë 13.7.2026	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	16696
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 189, datë 13.7.2026	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike	16697
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 190, datë 13.7.2026	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike...	16699
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 191, datë 13.7.2026	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Doma Group” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	16700
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 192, datë 13.7.2026	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Global Interprise Group” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	16701
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 193, datë 13.7.2026	Mbi fillimin e procedurës administrative për kërkesën e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	16702
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 194, datë 13.7.2026	Mbi fillimin e procedurës administrative për kërkesën e shoqërisë “Gerti” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	16704
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 195, datë 13.7.2026	Mbi fillimin e procedurës administrative për kërkesën e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) e aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a.....	16705
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 196, datë 13.7.2026	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 91, datë 2.4.2026, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Dion Energji’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 mw”, i ndryshuar.....	16707

Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 535/13, datë 23.7.2026	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugëve në qytet, për rrugën ‘Çel Islami’”.....	16708
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 778/9, datë 20.7.2026	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim, asfaltim e masa inxhinierike në km 21+050- 22+050, në rrugën ‘Qafëthanë–Lin–Pogradec’”, ndryshuar me VKM-në nr. 429, datë 26.6.2024.....	16709



LIGJ
Nr. 64/2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 8391, DATË 28.10.1998,
“PËR SHËRBIMIN INFORMATIV
KOMBËTAR”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8391, datë 28.10.1998, “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

1. Titulli i ligjit ndryshohet dhe zëvendësohet me “Për Shërbimin Informativ të Shtetit”.

2. Kudo në përmbajtje të ligjit bëhen këto ndryshime;

a) emërtimi “Shërbimi Informativ Kombëtar” zëvendësohet me emërtimin “Shërbimi Informativ i Shtetit”;

b) shkurtimi “SHIK” zëvendësohet me shkurtimin “SHISH”;

c) emërtimi “Nënkomisionit të Përhershëm Parlamentar” zëvendësohet me fjalët “komisionit përgjegjës për sigurinë”;

ç) fjalët “sigurimit kombëtar” zëvendësohen me fjalët “sigurisë kombëtare”;

d) fjalët “sigurimin kombëtar” zëvendësohen me fjalët “sigurinë kombëtare”.

Neni 2

Në paragrafin e parë të nenit 3 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Tri nënndarjet e para ndryshohen si më poshtë:

“Mbledh informacion brenda dhe jashtë vendit në funksion të sigurisë kombëtare, sigurisë kolektive dhe sfidave globale.

Mbledh informacion për kërcënimet që vijnë nga aktiviteti i shërbimeve të inteligjencës së huaj, në të gjitha format që shprehet dhe shfaqet, në funksion të ruajtjes së integritetit, pavarësisë dhe rendit kushtetues.

Mbledh informacion për terrorizmin dhe ekstremizmin, krimet kundër mjedisit, prodhimin dhe përhapjen e armëve të dëmtimit në masë, si dhe për stabilitetin e brendshëm dhe rajonal.”.

2. Pas nënndarjes së tretë shtohen dy nënndarje me këtë përmbajtje:

“Mbledh informacion për kërcënimet ndaj sigurisë ekonomike, kërcënimet kibernetike dhe kërcënimet hibride, me impakt në mjedisin e sigurisë së vendit.

Mbledh informacion për kërcënimet ndaj infrastrukturës kritike dhe të rëndësishme të Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 3

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Nënndarja e fundit e paragrafit të tretë shfuqizohet.

2. Në fund të nenit shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Drejtori dhe zëvendës drejtori i SHISH-it përfitojnë pagë bazë, shtesë për vjetërsi dhe shtesë për natyrë të veçantë pune. Trajtimi financiar i tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Drejtori dhe zëvendës drejtori trajtohen nga legjislacioni për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit.”.

Neni 4

Në paragrafin e fundit, të nenit 6 dhe në paragrafin parë, të nenit 7 fjala “Popullor” hiqet.

Neni 5

Në nenin 10 bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në fund të paragrafit të parë pas fjalëve “të personelit” shtohen fjalët “si dhe nga detyrimet që rrjedhin nga ligji për të drejtën e informimit.”.

2. Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Punonjësit e SHISH-it përjashtohen nga detyrimi për deklarimin e të ardhurave të përftuara



nga paga, si dhe deklarimin e kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë. Kontrolli vjetor i tyre kryhet nga struktura e posaçme në Shërbimin Informativ të Shtetit, sipas procedurave të përcaktuara me akt të brendshëm të drejtorit të SHISH-it.”.

Neni 6

Në fund të nenit 13 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“SHISH-i ka të drejtë për akses në bazat e të dhënave shtetërore, i cili është i kufizuar sipas funksionit ligjor dhe rregullohet me marrëveshje ndërinstytucionale.”.

Neni 7

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 2.7.2026.

DEKRET

Nr. 404, datë 23.7.2026

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Omar Fadil Malaj
2. Besmire Iljaz Ahmati
3. Laureta Nikolla Rungaja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 405, datë 23.7.2026

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Driada Zyhdi Ahluwalia
2. Valmira Muhamet Kraja
3. Olsa Hekuran Josif
4. Bjanka Muharrem Nuho

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 406, datë 23.7.2026****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Klea Qazim Gjana
2. Enkeleda Destan Brahaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 407, datë 23.7.2026****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Eriona Ilir Bytyçi
2. Ana Skender Deliallisi
3. Gëzim Pal Gjoka

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 408, datë 23.7.2026****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Zojë Ndue Rrahishta
2. Flonja Latif Drenofci
3. Devis Besnik Cani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 409, datë 23.7.2026****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

I lejohej lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Alketa Tosun Pllaha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 410, datë 23.7.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ledina Maksim Lamani
2. Zorada Idriz Bajrami

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 411, datë 23.7.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Sokol Tetem Ahmetaj
2. Skerdi Vezir Hoxha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 412, datë 23.7.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Saimir Vehbi Suçi
2. Fatbardh Ferit Markja



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 413, datë 23.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Albi Edmond Fagu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 414, datë 23.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Ahmet Enes Ali Musaoğullari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 415, datë 23.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Jakup Avdullah Durakaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 416, datë 23.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Festim Durak Fondaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 417, datë 23.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Dhurata Ukë Thaqi Fondaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 418, datë 23.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Idriz Esad Bojku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 419, datë 23.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Temmuz Erol Ülger

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 420, datë 23.7.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8/a, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Paolantonio Domenico Lippa

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 421, datë 23.7.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8/a, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Sait Mehmet Şerif Akyol

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 422, datë 23.7.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Sali Hamit Allmuça



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 423, datë 23.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Agim Hasan Musha
2. Edison Petrit Muça
3. Armela Qani Memeti
4. Griselda Dashnor Manjani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 424, datë 23.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetasve:

1. Mimoza Shefit Ahmetaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 425, datë 23.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Lendita Gjëm Bislimi
2. Vjollca Safet Ramqaj
3. Arbijon Ilmi Kolari
4. Egzon Behar Vehapi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 426, datë 23.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Andi Agim Jahja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 427, datë 23.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Fadile Safet Koçinaj
2. Serije Ismen Ademaj
3. Alberita Ismet Nezaj Alushaj
4. Sheadin Sadri Pulaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 428, datë 23.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Redon Armend Prekazi
2. Lum Armend Prekazi
3. Granit Sami Kastrati
4. Gentiana Sami Kastrati

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 429, datë 23.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Gëzim Neshat Morina
2. Valdet Refki Alushaj
3. Istref Muharrem Idrizaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 430, datë 23.7.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Blini Besnik Mejzini
2. Granita Sami Kastrati
3. Rezan Nazmi Saraç

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 431, datë 23.7.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Albin Mustafa Berisha
2. Arbër Mustafa Berisha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 137, datë 15.7.2026

**PËR BASHKËPUNIMIN NDËRMJET
STRUKTURAVE TË MINISTRISË SË
PUNËVE TË BRENDSHME,
MINISTRISË SË EKONOMISË DHE
INOACIONIT DHE SHËRBIMIT
INFORMATIV TË SHTETIT, PËR
PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LEJES
SË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 33, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit dhe drejtori i Shërbimi Informativ të Shtetit,



UDHËZOJNË:

I. AUTORITETET SHTETËRORE PËRGJEGJËSE

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse që bashkëpunojnë në procesin e lëshimit të lejes së qëndrimit për të huajt në Republikën e Shqipërisë, janë:

a) Në Ministrinë e Punëve të Brendshme (më poshtë “MPB”) – Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (më poshtë “DKM”);

b) Në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit (më poshtë “MEI”) – Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (më poshtë “AKPA”);

c) Shërbimi Informativ i Shtetit (më poshtë “SHISH”).

II. DEPOZITIMI I KËRKESËS PËR LEJE QËNDRIMI OSE LEJE UNIKE

1. Aplikimi për leje qëndrimi, apo për ripërtëritje të këtij dokumenti, bëhet *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania* nga vetë i huaji. Aplikimi për leje unike apo ripërtëritje të këtij dokumenti, bëhet nga vetë i huaji, punëdhënësi ose agjencia private e punësimit e licencuar me autorizimin e shtetasit të huaj ose punëdhënësit dhe i drejtohet autoritetit përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin që mbulon territorin, ku i huaji kryen ose do të kryejë aktivitetin në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Për procesimin e aplikimeve për leje qëndrimi ose leje unike, të dhënat përpunohen dhe replikohen ndërmjet tri sistemeve elektronike:

a) Sistemi *e-Visa* (VISA);

b) Sistemi i Shërbimeve të Punësimit (SSHP);

c) Sistemi FER – Moduli *e-Leje* qëndrimi (FER).

3. Në varësi të shtetësisë dhe të motivit të qëndrimit të përzgjedhur në aplikim, të dhënat e shtetasit të huaj, përfshirë dokumentacionin ligjor aksesohen nga sistemet, si më poshtë:

a) Kërkesat për leje qëndrimi për motive bashkimi familjar/studim/të tjera, aksesohen nga sistemet FER dhe VISA (nëse është kategori shtetësie që ka nevojë për vizë D);

b) Aplikimet për leje unike, aksesohen nga sistemet FER, SSHP, VISA (kur bën pjesë në kategoritë e shtetësisë që kanë nevojë për vizë të tipit D).

III. APLIKIMI PËR LEJE QËNDRIMI

1. Për kategoritë e të huajve që kanë nevojë për vizë tipi D, për t'u trajtuar me leje qëndrimi, aplikimi

i depozituar në portalin qeveritar *e-Albania* aksesohet njëherësh nga sistemet VISA dhe FER.

2. Në sistemin VISA, aplikimi procesohet në përputhje me udhëzimin e përbashkët, midis ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministrit të Punëve të Brendshme dhe Shërbimit Informativ të Shtetit. Në përfundim të vlerësimit, krahas njoftimit *online* të shtetasit të huaj, njoftohet MEI dhe autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin (DVKM) nëpërmjet sistemit *online* mbi miratimin/refuzimin e vizës tipi D për aplikantin e huaj. Në sistemin FER, aplikimi mbetet në statusin “në pritje”, deri në momentin kur i huaji hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me vizë të tipit D.

3. Struktura pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, brenda 1 (një) ditë pune, shqyrton aplikimin/dokumentacionin e ngarkuar në portalin unik qeveritar *e-Albania* për leje qëndrimi ose për ripërtëritjen e saj. Në rastet kur kërkohet miratimi i vizës nga MEPJ-ja, pasi shtetasi i huaj ka hyrë në territor dhe dokumentacioni i paraqitur rezulton në përputhje me kriteret ligjore, kjo strukturë e pajis atë me leje provizore me afat 1-mujor (njëmuajor), e cila i dërgohet automatikisht në adresën elektronike të deklaruar në formularin e aplikimit *online*.

4. Në rastet kur nga shtetasi i huaj kërkohet në rrugë elektronike shtyrja e afatit të lejes provizore, drejtuar strukturës pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, kjo strukturë e pajis shtetasin e huaj me leje provizore të shtyrë, me një afat jo më shumë se 30 ditë. Lista me aplikimet e pranuar nga specialistët e migracionit DVKM-së, nëpërmjet një procedure të automatizuar i kalon për shqyrtim shëfit të Sektorit të Migracionit të DVKM-së në sistemin FER, i cili, pas vlerësimit, ia përcjell për miratim drejtuesit të drejtorisë vendore për kufirin dhe migracionin.

5. Specialisti i migracionit që trajton rastin, brenda 1 (një) dite pune, vlerëson aplikimin dhe komunikon me aplikantin nëpërmjet postës elektronike të portalit qeveritar (FER – aplikime *online*), sipas rasteve, si vijon:

a) nëse konstaton se informacioni apo dokumentacioni i ngarkuar nga aplikanti është i paplotë, njofton të huajin për mangësitë e konstatuara dhe i kërkon plotësimin dhe ngarkimin e tyre *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania*, tek opsioni “Dokumentacion plotësues”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike;



b) nëse konstaton se nuk janë përmbushur kriteret ligjore, njofton aplikantin mbi refuzimin e kërkesës për mospërmbushje të kriterëve ligjore.

6. Mosplotësimi i dokumenteve të munguara brenda afateve të përcaktuara, sjell refuzimin e aplikimit për leje qëndrimi.

7. Struktura pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin pranon aplikimin e të huajt për leje qëndrimi, brenda afateve të përcaktuara në nenin 37, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, dhe në përputhje me kriteret e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

8. Nëse rezulton se i huaji, në raste specifike të përcaktuara në pikën 1, shkronja “a”, dhe në pikën 2, të nenit 34, të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt”, të ndryshuar, nuk ka përmbushur kriteret e hyrjes dhe të qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, struktura pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, i komunikon mospërmbushjen e kriterit dhe i kërkon të përcjellë nëpërmjet postës elektronike arsyen dhe dokumentacionin përkatës, që justifikon shkeljen e kriterit ligjor.

9. Për të huajt që përmbushin kriteret sipas nenit 52, nenit 53, dhe shkronjës “dh”, të pikës 1, të nenit 87, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, aplikimi për leje qëndrimi dhe dokumentacioni i nevojshëm ligjor, përcillet me shkresë zyrtare nga autoriteti përgjegjës që trajton kategoritë specifike të të huajve, në përputhje me këto nene, pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin. Kërkesa hidhet manualisht në sistemin FER nga specialisti i migracionit dhe përcillet për vlerësim në strukturat përkatëse. Pas miratimit të lejes së qëndrimit, njoftimi i dërgohet zyrtarisht autoritetit që ka sjellë kërkesën për pajisjen me leje qëndrimi, i cili e njofton të huajin për vijimin e procedurave të mëtejshme.

10. Në rast se i huaji deklaron në formularin e aplikimit *online* për leje qëndrimi se ka qenë i dënuar në vendin e origjinës, specialisti i migracionit, nëpërmjet postës elektronike të portalit qeveritar, i përcjell të huajt njoftimin për të depozituar nëpërmjet postës elektronike të portalit, dëshminë e penalitetit me vulë apostile të lëshuar në 6-mujorin (gjashëmujorin) e fundit, të përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Specialisti i migracionit

kërkon që dëshmia penale origjinale të dorëzohet pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin nëpërmjet shërbimit postar. Në rastet kur dëshmia e penalitetit përmban të dhëna për krime kundër familjes, krime seksuale, sidomos kundër fëmijëve, të vlerësohet nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin nëse përmbushen kushtet për vazhdimin e procedurës së mëtejshme. Nëse dëshmia e penalitetit nuk dorëzohet, aplikimi për leje qëndrimi refuzohet dhe nga ana e specialistit bëhen shënimet në FER.

11. Pas pranimit të aplikimit për leje qëndrimi dhe regjistrimin e aplikimit në modulën *e-Leje* qëndrimi, i huaji, brenda 1 (një) dite pune, pajiset me leje qëndrimi provizore në formatin elektronik, me afat vlefshmërie 1 (një) muaj, deri në marrjen e përgjigjes mbi aplikimin e dorëzuar. Në rastet e shtyrjes së këtij afati për arsye administrative, zyra pritëse në autoritetin vendor për kufirin dhe migracionin njofton të huajin për datën e re të përgjigjes, sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative. Lista me aplikimet e pranuar nga specialistët e migracionit, nëpërmjet një procedure të automatizuar i kalon për shqyrtim shefit të Sektorit të Migracionit në sistemin FER, që, pas vlerësimit, ia kalon për miratim drejtuesit të drejtorisë vendore për kufirin dhe migracionin. Leja provizore e miratuar i dërgohet automatikisht të huajt në adresën elektronike që ka vendosur në formularin e aplikimit *online*.

12. Në rast të refuzimit të aplikimit për leje qëndrimi, pagesa e tarifës është e pakthyeshme, pasi mbulon shërbimin e kryer.

13. Në rastet kur nga institucioni i interesuar bëhet një kërkesë për pajisjen e të huajt me leje qëndrimi, aplikimi nuk kryhet nëpërmjet depozitimit të kërkesës *online* në portalin qeveritar, por duhet të depozitohet në formë shkresore pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin. Kërkesa hidhet manualisht në sistemin FER nga specialisti i migracionit dhe përcillet për vlerësim në strukturat përkatëse.

IV. APLIKIMI PËR LEJE UNIKE

1. Për kategoritë e shtetasve të huaj që aplikojnë për herë të parë për leje unike dhe që kanë nevojë për vizë tipi D, aplikimi i depozituar në portalin unik qeveritar *e-Albania* aksesohet njëherësh nga sistemet SSHP, VISA dhe FER.

2. Aplikimi për leje unike shqyrtohet nga autoriteti vendor i kufirit dhe migracionit, ku i huaji



ushtron aktivitetin, me përjashtim të punonjësve lëvizës digjitalë, të cilët aplikojnë aty ku kanë vendqëndrimin.

3. Të gjitha aplikimet për leje unike të të huajve, për të cilat sipas legjislacionit në fuqi kërkohet miratim për punësim nga AKPA-ja, aksesohen nga sistemi SSHP.

4. Në sistemin SSHP, aplikimi i të huajit që kërkon të punësohet/vetëpunësohet në Republikën e Shqipërisë, shqyrtohet në zbatim të legjislacionit në fuqi për të huajt dhe, nëse konstatohet se:

a) informacioni apo dokumentacioni i ngarkuar është i paplotë: i huaji njoftohet brenda 1 (një) ditë pune për mangësitë e konstatuara dhe i kërkohet plotësimi i tyre brenda një periudhe 1-javore (njëjavore);

b) informacioni dhe dokumentacioni janë të plotë ose pasi janë plotësuar, autoriteti përgjegjës, brenda 1 (një) dite pune, vlerëson përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore, dhe vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës;

c) në rast refuzimi për shkak të mospërmbushjes së kriterëve ligjore, aplikanti njoftohet për vendimin e marrë, duke cituar dispozitën përkatëse të legjislacionit në fuqi.

5. Në përfundim të vlerësimit, krahas njoftimit *online* të të huajit, njoftohen edhe strukturat përkatëse në sistemet VISA dhe FER *online*, mbi miratimin apo refuzimin e kërkesës së punësimit/vetëpunësimit për aplikantin e huaj. Në sistemin VISA aplikimi mbetet në statusin “në pritje” deri në momentin e miratimit të punësimit, ndërsa në sistemin FER aplikimi mbetet në statusin “në pritje”, deri në momentin që i huaji hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me vizë tipi D.

V. PRANIMI I APLIKIMIT PËR LEJE QËNDRIMI OSE LEJE UNIKE

1. Pranimi i dokumentacionit të saktë për leje qëndrimi ose leje unike është përgjegjësi e strukturës pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, referuar përcaktimeve në ligjin nr. 79/2021, “Për të huajt”, i ndryshuar.

2. Pranimi i dokumentacionit, përfshin:

a) përputhshmërinë me dokumentacionin dhe përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar;

c) konsultimet me baza të tjera të dhënash;

ç) trajtimin e kërkesave specifike rast pas rasti.

3. Në rast të aplikimit për leje qëndrimi/leje unike apo rinovim të tyre dhe aplikimi është bërë jashtë afateve të përcaktuara në nenin 37, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, struktura e migracionit pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin vlerëson besueshmërinë e arsyeve të tejkallimit të afateve që paraqet shtetasi i huaj dhe vendos vijimin e procedurës me masë administrative sipas përcaktimeve në shkronjën “a/i”, pika 1, e nenit 141, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar. Arsyeja e tejkallimit të afateve për aplikim, si dhe masa administrative e marrë, shënohen si “koment” në modulën *e-Leje* qëndrimi.

4. Në rast se aplikimi për leje qëndrimi/leje unike apo rinovim është bërë jashtë afateve të përcaktuara në nenin 37, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, struktura e migracionit pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin vlerëson se arsyet nuk justifikojnë moskryerjen e aplikimit në afat, refuzon aplikimin, dhe njofton shtetasin e huaj për arsyet e refuzimit të aplikimit. Arsyet e refuzimit reflektohen në rubrikën shënime në FER.

5. Personat, sipas parashikimeve të nenit 52, nenit 53 dhe shkronjës “dh”, të pikës 1, të nenit 87, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, përjashtohen nga aplikimi i masave ndëshkimore, në zbatim të procedurave të pranimit të aplikimit për leje qëndrimi dhe rinovimin e saj.

VI. VLERËSIMI I APLIKIMIT PËR LEJE QËNDRIMI OSE LEJE UNIKE

1. Në vlerësimin e aplikimit për leje qëndrimi ose leje unike marrin pjesë strukturat përgjegjëse të autoritetit vendor dhe qendror të kufirit dhe migracionit, strukturat përgjegjëse të informacionit kriminal në Policinë e Shtetit, si dhe strukturat përgjegjëse të Shërbimit Informativ të Shtetit.

2. Strukturat përgjegjëse pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, sipas fushës së përgjegjësisë dërgojnë lejen provizore elektronikisht tek i huaji, si dhe dërgojnë, brenda 2 (dy) ditëve pune, për vlerësim, në formë elektronike pranë autoritetit qendror për kufirin dhe migracionin, çdo aplikim të miratuar nga autoritet vendore për kufirin dhe migracionin, duke bërë komentet përkatëse në modulën *e-Leje* qëndrimi të sistemit FER.



3. Struktura e migracionit në autoritetin qendror për kufirin dhe migracionin trajton aplikimet në sistem, kryen verifikime të dokumenteve për raste ku kërkohet vlerësim i veçantë, duke proceduar rast pas rasti. Struktura e migracionit, brenda 2 (dy) ditëve pune dërgon elektronikisht për vlerësim tek strukturat përgjegjëse të SHISH-it dhe Departamentit të Policisë Kriminale, pranë autoritetit qendror të Policisë së Shtetit të gjitha aplikimet e dërguara nëpërmjet sistemit FER nga autoriteti vendor përgjegjës për kufirin dhe migracionin.

4. Struktura përgjegjëse e Departamentit të Policisë Kriminale pranë autoritetit qendror të Policisë së Shtetit dhe strukturat përgjegjëse të SHISH-it, të ngarkuar për këtë qëllim, kryejnë verifikimet e nevojshme në bazat e tyre të të dhënave ndaj të huajve, të cilët kanë aplikuar për leje qëndrimi ose leje unike dhe bëjnë vlerësimin e tyre nëse janë dakord apo jo për lëshimin e lejes, brenda 5 ditëve pune në rastin e lejeve unike dhe 7 ditë pune në rastet e lejeve të qëndrimit. Në rastet e vlerësimit negativ për lëshimin e saj, autoritetet e sipërcituara ia komunikojnë me shkresë zyrtare autoritetit qendror për kufirin dhe migracionin referencën ligjore mbi të cilën bazojnë vendimin për refuzimin e aplikimit, si dhe afatin e refuzimit të hyrjes për shtetasin e huaj, nëse kjo është e nevojshme.

5. Autoriteti qendror për kufirin dhe migracionin, brenda 3 (tre) ditësh pune, referuar vlerësimeve sipas pikës 4, vendos për miratimin ose refuzimin e aplikimit për leje qëndrimi ose leje unike.

6. Struktura pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, brenda 2 ditëve pune, njofton të huajin për miratimin e lejes së qëndrimit elektronikisht, duke e informuar për hapat e mëtejshëm.

7. Me qëllim unifikimin e procedurës për mënyrën e përlogaritjes së fillimit të afatit të lejes së

qëndrimit/lejes unike, si datë fillimi, pas miratimit nga të gjitha strukturat përgjegjëse, do të jetë data e pajisjes së të huajt me leje provizore.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit ose të lejes unike, ndiqet e njëjta procedurë si në rastin e kërkesës për pajisje për herë të parë, përjashtuar aplikimin për vizë për kategorinë e shtetasve të huaj që kërkojnë pajisjen me vizë të tipit D, kur aplikojnë për herë të parë.

2. Kërkesat dhe procedurat administrative që preken nga ky udhëzim zbatohen pas përmirësimit të sistemeve elektronike që preken nga këto procedura.

3. Udhëzimi i përbashkët nr. 196, datë 14.10.2024, “Për bashkëpunimin ndërmjet strukturave të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Shërbimit Informativ të Shtetit, për procedurat e lëshimit të lejes së qëndrimit për të huajt”, shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe Shërbimi Informativ i Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME

Besfort Lamallari

MINISTËR I EKONOMISË

DHE INOVACIONIT

Delina Ibrahimaj

DREJTOR I SHËRBIMIT
INFORMATIV TË SHTETIT

Vlora Hyseni



ANEKSI NR. 1

DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN _____

NJOFTIM

Ju njoftojmë se leja e qëndrimit/leja unike për shtetasin _____, me dokument udhëtimi nr. _____, FID _____ është miratuar.

Për lëshimin e dokumentit biometrik leje qëndrimi/unike, ju duhet të:

Hapi 1: Konfirmoni adresën e saktë të vendqëndrimit në Zyrën e Gjendjes Civile të bashkisë/njësisë administrative (duke paraqitur brenda 30 ditëve këtë njoftim të printuar, dokumentin e udhëtimit dhe dokumentin e pronësisë së banesës/kontratë qiramarrje/kontratë huadhënie).

Hapi 2: Kryeni pagesën për vlerën e kartës biometrike, duke blerë kuponin në filialet e Postës Shqiptare.

Hapi 3: Paraqituni në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin ose Komisaratin e Policisë Kufitare dhe Migracionit _____, për të kryer procedurën e pajisjes me kartën biometrike leje qëndrimi/leje unike për të huajt.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Specialisti i Migracionit _____

Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin/Komisariati i Policisë Kufitare dhe Migracionit _____

NOTE

We inform you that your Residence Permit/Single Permit for citizens _____, Travel Document no. _____, FID _____ has been approved.

To issue a biometric document Residence Permit/Unique Permit, you need:

Step 1: *Confirm the correct residential address at the Civil Registry Office of the municipality/administrative unit (submitting this printed notice, travel document and the property Ownership document/rental agreement/lending contract within 30 days).*

Step 2: *Make the payment for the biometric card by purchasing a coupon at the branches of the Post Office.*

Step 3: *Be present at the Local Director for Border and Migration or Border and Migration Commissariat _____ to perform the procedure for equipment with the biometric card Residence Permit for Foreigners.*

Thank you for understanding!

Migration Specialist _____ Local Director for Border and Migration or Border and Migration Commissariat _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA RAJONALE E KUFIRIT DHE MIGRACIONIT
REFUZIM/HEQJA E LEJES SË QËNDRIMIT/LEJES UNIKE
REFUSAL/WITHDRAWAL OF RESIDENCE PERMIT/UNIQUE PERMIT

Më në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin
On at the Regional Directorate for Border and Migration

☐ I refuzohet leja e qëndrimit shtetasit: ☐ I hiqet leja e qëndrimit shtetasit:
The citizen's residence permit is refused: The citizen's residence permit is revoked:

Mbiemri
Family name

Emri
First name

Datëlindja
Date of birth

Vendlindja
Place of birth

Gjinia
Sex

Shtetësia
Nationality

Banues në
Resident in

Dokumenti i udhëtimit nr.
Travel document no.

Lëshuar në
Issued in

Më
on

në mbështetje të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt" të ndryshuar, për arsyet në vijim:
based on Law No. 79/2021, "On Foreigners", as amended, for the following reasons:

☐ **A.** Ka shkelur afatet e aplikimit për leje qëndrimi pa motiv (neni 34/1(a), i ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar).
Groundless violation of the time limit for residence permit application (Article 34/1(a) of Law No. 79/2021 "On Foreigners", as amended).

☐ **B.** Nuk plotëson kushtet e nevojshme për qëndrim (neni 34/1(b), i ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar) referuar:
The applicant _____ (Article 34/1(b) of Law No. 79/2021 "On Foreigners", as amended).

☐ **C.** Përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë publike dhe është subjekt i largimit nga territori i Republikës së Shqipërisë (neni 34/1(c), i ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar).
The applicant is a threat to public order and security, and he is subject to removal from the territory of the Republic of Albania (Article 34/1(c) of the Law No. 79/2021, "On Foreigners", as amended).

☐ **Ç.** Nuk ekzistojnë me arsyet për të cilat është lëshuar leja e qëndrimit (neni 34/1(d), i ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar).
-The reasons for which the residence permit is issued no longer exist (Article 34/1(d) of Law No. 79/2021, "On Foreigners", as amended).

☐ **D.** Ka qëndruar mbi 180 ditë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (neni 34/1(e), i ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar).
-The applicant _____ (Article 34/1(e) of Law No. 79/2021 "On Foreigners", as amended).

Komente/Comments

Personi i interesuar mund të ankohet ndaj vendimit për refuzimin e lejes së qëndrimit, sipas parashikimeve të ligji nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar, dhe parashikimeve të legjislationit shqiptar.

The person concerned may appeal against the decision refusing the resident permit as provided for in the law No.79/2021 "On Foreigners", as amended" and in the provisions of the Albanian legislation.

Personi i interesuar
Person concerned

Autoriteti
Authority



URDHËR
Nr. 162, datë 20.7.2026

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR KËRKESAT E PËRBASHKËTA TË
PËRDORIMIT TË HAPËSIRËS AJRORE
DHE PROCEDURAVE TË OPERIMIT
PËR SHMANGIEN E PËRPLASJEVE
AJRORE¹**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “ç”, të nenit 7 dhe nenit 81, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për kërkesat e përbashkëta të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurave të operimit për shmangien e përplasjeve ajrore”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Urdhri nr. 124, datë 28.9.2015, “Për miratimin e rregullore për kërkesat e përbashkëta të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurave të operimit për shmangien e përplasjeve ajrore”, shfuqizohet.

3. Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ky urdhër shfuqizohet.

4. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

RREGULLORE
**PËR KËRKESAT E PËRBASHKËTA TË
PËRDORIMIT TË HAPËSIRËS AJRORE DHE
PROCEDURAVE TË OPERIMIT PËR
SHMANGIEN E PËRPLASJEVE AJRORE**

Neni 1

Përmbajtja e lëndës dhe fushëveprimi

Kjo rregullore përcakton kërkesat e përbashkëta të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurat e operimit për shmangien e përplasjeve ajrore për t'u përmbushur nga:

a) operatorët e avionit referuar në nenin 2(1)(b)(i) dhe 2(1)(b)(ii), të vendimit nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar për fluturimet e ndërmarra në, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë; dhe

b) operatorët e avionit referuar në nenin 2(1)(b)(i), të vendimit nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar për fluturimet e ndërmarra në hapësirën ajrore mbi territorin në të cilin zbatohet marrëveshja shumëpalëshe, ratifikuar në vendin tonë me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian”.

¹ Ky urdhër përaftron plotësisht rregulloren nr. 1332/2011, e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2011, “Për kërkesat e përbashkëta të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurave të operimit për shmangien e përplasjeve ajrore”. Numri CELEX 32011R1332, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 336, 20.12.2011, ndryshuar me rregulloren nr. 2016/583. Numri

CELEX 32016R0583, botuar Fletoren Zyrtare të BE-së OJ L 101, 16.4.2016, rregulloren nr. 2025/343. Numri CELEX 32025R0343, botuar në Fletoren Zyrtare OJ L, 2025/343, 18.2.2025 dhe korrigjuar me rregulloren nr. 2025/90823. Numri CELEX 32025R0343R(01), botuar Fletoren Zyrtare të BE-së OJ L, 2025/90823, 22.10.2025.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. **“Sistemi për shmangien e përplasjeve ajrore (ACAS)”** nënkupton një sistem avioni i bazuar në sinjalet e transponderit të radarit mbikëqyrës sekondar (SSR), i cili operon në mënyrë të pavarur nga pajisjet bazë të tokës, për t’i dhënë këshilla pilotit mbi konflikte potenciale me avionë, të cilët janë të pajisur me transpondera SSR;

2. **“Sistemi për shmangien e përplasjeve ajrore II (ACAS II)”** nënkupton një sistem për shmangien e përplasjeve ajrore, i cili siguron këshillat për zgjidhjet vertikale përveç këshillave të trafikut;

3. **“Treguesi i rekomanduar (RA) i zgjidhjes”** nënkupton një tregues të caktuar për të rekomanduar ekuipazhin e fluturimit në një manovër, me qëllim që të sigurojë ndarjen nga të gjitha kërcënimet ose një kufizim manovrues që synon të ruajë ndarjen ekzistuese;

4. **“Tregues i rekomanduar (TA) i trafikut”** nënkupton një tregues i caktuar për ekuipazhin e fluturimit se afërsia e një tjetër avioni është një kërcënim potencial.

Neni 3
Sistemi për shmangien e përplasjeve ajrore (ACAS)

1. Aeroplanët e përmendura në seksionin I, të aneksit të kësaj rregulloreje, do të jenë të pajisur dhe operojnë në përputhje me rregullat dhe procedurat siç specifikohen në aneks.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masa që të sigurojë operimin e avionëve referuar në nenin 2(3)(a), të vendimit nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në aneks, në përputhje me kushtet e përcaktuara në atë nen.

Neni 4
Zbatimi

Në rastin e një avioni me një certifikatë individuale të vlefshmërisë ajrore të lëshuar para datës 1 mars 2012, dispozitat e nenit 3 do të zbatohen duke filluar nga data 1 dhjetor 2015.

ANEKS
SISTEMET PËR SHMANGIEN E
PËRPLASJEVE AJRORE (ACAS) II
(Part-ACAS)

AUR.ACAS.1005 Kërkesa e performancës

1. Aeroplanët e mëposhtëm me turbinë duhet të jenë të pajisur me ACAS II me version logjik 7.1 për shmangien e përplasjes ose me ACAS Xa:

a) avionët me një masë maksimale të certifikuar të ngritjes që tejkalon 5700 kg;

b) avionët e autorizuar për të transportuar më shumë se 19 pasagjerë.

2. Avionët që nuk përmenden në pikën 1, por që janë të pajisur në mënyrë vullnetare me ACAS II, duhet të kenë një version logjik 7.1 për shmangien e përplasjes ose me ACAS Xa.

3. Pika 1 nuk zbatohet për sistemet e avionit pa pilot.

AUR.ACAS.1010 Trajnimi i ACAS II

Operatorët duhet të krijojnë procedura operative dhe programe trajnimi të ACAS II, në mënyrë që ekuipazhi i fluturimit të trajnohet siç duhet për shmangien e përplasjeve dhe të bëhet kompetent në përdorimin e pajisjeve ACAS II.

URDHËR
Nr. 163, datë 20.7.2026PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË URDHRIN NR. 143, DATË 18.7.2022,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
MBI RREGULLAT DHE PROCEDURAT
PËR OPERIMIN E AVIONËVE
PA PILOT”²

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr.

² Ky urdhër përaftron pjesërisht Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 2024/1110, të datës 10 prill 2024, që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 748/2012, sa i përket vlefshmërisë fillestare të sistemeve ajrore pa pilot që i nënshtrohen certifikimit dhe
Faqe | 16662

Rregulloren Zbatuese (BE) 2019/947, në lidhje me rregullat dhe procedurat për operimin e mjeteve ajrore pa pilot. Numri CELEX 32024R1110, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L, 2024/1110, datë 23.5.2024.



96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” dhe në përputhje me vendimin nr. 1095, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

I. Në urdhrin nr. 143, datë 18.7.2022, “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë”, të bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i urdhrit “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë” zëvendësohet me “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e sistemeve të avionëve pa pilotë”;

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ky urdhër shfuqizohet”.

II. Në rregulloren bashkëlidhur urdhrit bëhen shtesat dhe ndryshimet sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

III. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

Në rregulloren e miratuar me urdhrin nr. 143, datë 18.7.2022, “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Titulli i rregullores zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“Rregullore mbi rregullat dhe procedurat për operimin e sistemeve të avionëve pa pilotë”.

2. Neni 2 ndryshohet, si më poshtë:

i. paragrafi i parë zëvendësohet me sa vijon:

“Për qëllimet e kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme”;

ii. pika 1 zëvendësohet me sa vijon:

“1. **“Sistem i avionit pa pilot (UAS)”** (*unmanned aircraft system*), do të thotë një avion pa pilot, siç përcaktohet në nenin 3(2), të VKM-së nr. 1095, datë

24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar dhe njësisë e tij e kontrollit dhe monitorimit”;

iii. pikat 26 dhe 27 zëvendësohen me sa vijon:

“26. **“Njësia e kontrollit dhe monitorimit (CMU)”** (*control and monitoring unit*), është pajisja ose sistemi i pajisjeve për të kontrolluar dhe monitoruar avionin pa pilot nga distanca, siç përcaktohet në nenin 3(17), të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar;

27. **“Lidhja C2”** është lidhja e të dhënave ndërmjet avionit pa pilot (UA) dhe CMU-së, me qëllim menaxhimin e fluturimit”;

iv. shtohet pika 36. si më poshtë:

“36. **“Komponent i UAS-së”** do të thotë çdo motor, helikë ose pjesë e UA-së, ose çdo element i njësisë së kontrollit dhe monitorimit (CMU)”;

3. Në nenin 7, shtohet një paragraf i ri “2a”, si më poshtë:

“2a. Operatori i një UAS-je që plotëson kushtet e specifikuar në pikën 1(d), të nenit 19, të urdhrit nr. 114, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për sistemet e avionëve pa pilot dhe operatorët e sistemeve të avionëve pa pilot”, duhet të marrë certifikatat e mëposhtme:

i. një certifikatë të vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore të lëshuar në përputhje me nënpjesën H, të aneksit I (pjesa 21), të urdhrit nr. 57, datë 13.3.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe kërkesat e aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit”;

ii. një certifikatë zhurme, të lëshuar në përputhje me nënpjesën I, të aneksit I (pjesa 21), të urdhrit nr. 57, datë 13.3.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe kërkesat e aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit”, kur UA-ja i nënshtrohet kërkesave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në pikën 21.B.85 të të njëjtit urdhër.”

4. Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

i. paragrafi 2 zëvendësohet me sa vijon:

“2. AAC-ja jep një autorizim operacional kur:



a) vlerësimi i kryer në përputhje me paragrafin 1 arrin në përfundimin, se:

i. objektivat e sigurisë në operim (*safety*) marrin parasysh risqet e operimit;

ii. kombinimi i masave zbutëse që lidhen me kushtet operacionale për kryerjen e operimit, kompetencën e personelit të përfshirë dhe karakteristikat teknike të avionit pa pilot, janë të përshtatshme dhe mjaftueshëm të qëndrueshme për ta mbajtur operimin të sigurt, në raport me rreziqet në tokë dhe ajër të identifikuar;

b) për UAS-të që janë certifikuar ose do të certifikohen në përputhje me nenin 19, pika 1(d), e urdhrin nr. 114, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për sistemet e avionëve pa pilot dhe operatorët e sistemeve të avionëve pa pilot”, UAS-të kanë:

i. një certifikatë të vlefshme të vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore dhe, nëse UA-ja i nënshtrohet kërkesave të mbrojtjes mjedisore të përcaktuara në pikën 21.B.85, të urdhrin nr. 57, datë 13.3.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe kërkesat e aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit”, një certifikatë të vlefshme zhurme; ose

ii. nëse UA-ja nuk i plotëson, ose nuk është provuar se i plotëson, kërkesat e zbatueshme të vlefshmërisë ajrore, kushtet e fluturimit të miratuara sipas nënpjesës P, të aneksit I (pjesa 21), të urdhrin nr. 57, datë 13.3.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe kërkesat e aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit”;

c) operatori i UAS-së i paraqet AAC-së një deklaratë që konfirmon se operimi i synuar përputhet me çdo rregull të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, veçanërisht në lidhje me privatësinë, mbrojtjen e të dhënave, përgjegjësinë, siguracionin, sigurinë (*security*) dhe mbrojtjen e mjedisit.”;

ii. në paragrafin 4, shkronja “c”, shtohen pikat e mëposhtme “vii” dhe “viii”:

“vii. certifikata e vlefshmërisë ajrore ose certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore dhe certifikata e zhurmës, kur janë lëshuar certifikata të tilla;

viii. kushtet e fluturimit të miratuara në përputhje me urdhrin nr. 57, datë 13.3.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe kërkesat e aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit”, ku UAS-ja përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 19, pika 1(d), të urdhrin nr. 114, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për sistemet e avionëve pa pilot dhe operatorët e sistemeve të avionëve pa pilot” dhe UA-ja nuk përmbush, ose nuk është provuar se përmbush, kërkesat përkatëse të vlefshmërisë ajrore.”

5. Në nenin 19, shtohet paragrafi 6, si më poshtë:

“6. Pavarësisht urdhrin nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, operatori UAS i një avioni pa pilot, dizajni i të cilit është i certifikuar, duhet t'i raportojë mbajtësit të miratimit të projektimit të UAS-së ose të komponentit të UAS-së çdo ngjarje ose gjendje të lidhur me sigurinë në operim të UAS-së ose të komponentit të UAS-së të identifikuar nga organizata. Në veçanti, operatori i UAS-së duhet të raportojë çdo aksident ose incident serioz që përfshin UAS-në ose komponentin e UAS-së, i cili rrezikon ose, nëse nuk korrigjohet apo trajtohet siç duhet, mund të rrezikojë sigurinë në operim të UAS-së ose të çdo personi fizik apo juridik.”

6. Aneksi “Operimet UAS në kategoritë ‘e hapur’ dhe ‘specifike’” ndryshohet, si më poshtë:

1. Në pjesën A (Operimet UAS në kategorinë e hapur), në nënseksionin UAS.OPEN.020, pika 4 “b” ndryshohet, si më poshtë:

“b) në rastin e një klase avionësh pa pilot C1, siç përcaktohet në pjesën 2 të aneksit të rregullores së miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 114, datë 6.6.2022, ka përfunduar një kurs trajnimi *online*, i ndjekur nga përfundimi me sukses i një provimi *online* të njohurive teorike, të kryer nga AAC-ja ose nga një subjekt i njohur/përcaktuar nga AAC-ja ose shtetit anëtar të regjistrimit të operatorit UAS, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, duke arritur të paktën 75% të pikëve totale. Provimi do të



përfshijë 40 pyetje me zgjedhje të shumëfishta, të shpërndara në mënyrë të përshtatshme në të gjitha lëndët vijuese.”.

2. në pjesën B “Operimet UAS në kategorinë “specifike”, pika UAS.SPEC.100 zëvendësohet me sa vijon:

“UAS.SPEC.100 Përdorimi i pajisjeve të certifikuara dhe avionëve të certifikuar pa pilot

1. Kur operatori i UAS-së përdor një avion pa pilot për të cilin është lëshuar një certifikatë e vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë e kufizuar e vlefshmërisë ajrore, operatori i UAS-së duhet të sigurojë që sistemi i avionit pa pilot të jetë në përputhje me “Rregulloren mbi rregullat e detajuara për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të sistemeve të certifikuara të avionëve pa pilot dhe komponentëve të tyre, si dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra”, që përafron Rregulloren e deleguar të Komisionit Evropian 2024/1107, kur të jetë e zbatueshme në legjislacionin e brendshëm.

2. Kur operatori i UAS-së përdor pajisje të certifikuara në një avion pa pilot, për të cilin nuk është lëshuar as certifikatë e vlefshmërisë ajrore dhe as certifikatë e kufizuar e vlefshmërisë ajrore, operatori i UAS-së duhet të kryejë të gjitha detyrat e mëposhtme:

i. të regjistrojë operimin ose kohën e shërbimit, në përputhje me udhëzimet ose procedurat e zbatueshme për pajisjen(t) e certifikuar;

ii. të ndjekë udhëzimet e përmendura në certifikatën e pajisjeve, dhe, gjithashtu, të përmbushë çdo direktivë të zbatueshme të vlefshmërisë ajrore të lëshuar nga EASA, e të pranuar dhe publikuar nga AAC-ja;

iii. të zbatojnë çdo masë të sigurisë në operim të vendosur nga AAC-ja në përputhje me nenin 19(4);

iv. të përdorë çdo informacion të rëndësishëm të detyrueshëm për sigurinë, të lëshuar nga EASA-ja, e të pranuar dhe publikuar nga AAC-ja.”.

3. Shtojca 1 ndryshohet si më poshtë:

a) në pikën UAS.STS-01.040 “Përgjegjësitë e pilotit në distancë”, pika 2/“f” zëvendësohet me sa vijon:

“f) nuk duhet t’ia dorëzojë kontrollin e avionit pa pilot një CMU-je tjetër;”;

b) në pikën UAS.STS-02.040 “Përgjegjësitë e pilotit në distancë”, pika 2/“e” zëvendësohet me sa vijon:

“e) nuk duhet t’ia dorëzojë kontrollin e avionit pa pilot një CMU-je tjetër;”.

URDHËR

Nr. 305, datë 20.7.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN
NR. 99, DATË 25.5.2021, “PËR
MIRATIMIN E KATALOGUT
KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE
PROFESIONALE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të nenit 17, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e ndryshimeve në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale, sipas shtojcës 1.2, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Botimin e ndryshimeve dhe të Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I EKONOMISË
DHE INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj**



Shtojca 1.2: Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale – 2026

Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale – 2026									
Nr.	Varianti i mëparshëm i kualifikimit profesional	Kodi i kualifikimit profesional dhe i njësive të të nxënës	Emërtimi i kualifikimeve	Emërtimi i njësive të të nxënës	Lloji i kualifikimit profesional	Profesionet LKP	Lidhja me kodet e LKP/ISCO	Kualifikim i plotë/pjeshtë	Niveli në KSHK
1		A6-III-26	Teknologji e përpunimit të brumërave		Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	PUNONJËS PËR PRODUKTE BRUMI	7513	I plotë	3
1-a		NjN-01-III-0476-26		Kimi analitike dhe ushqimore	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
1-b		NjN-01-III-0477-26		Mikrobiologji ushqimore	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
1-c		NjN-01-III-0478-26		Bazat e të ushqyerit	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
1-d		NjN-01-III-0479-26		Cilësia dhe siguria ushqimore	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
1-e		NjN-01-III-0480-26		Ruajtja dhe konservimi i produkteve ushqimore	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
1-f		NjN-01-III-0481-26		Prodhim i produkteve dietike të brumit	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
1-g		NjN-01-III-0482-26		Rregullat e higjienës personale, sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
1-h		NjN-01-III-0483-26		Proceset dhe aparatet në industrinë ushqimore	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
1-i		NjN-01-III-0484-26		Planifikimi dhe organizimi i punës në teknologjinë e përpunimit të brumërave	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
1-j		NjN-01-III-0485-26		Prodhim i miellit	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
1-k		NjN-01-III-0486-26		Prodhim i bukës	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
1-l		NjN-01-III-0487-26		Prodhim i makaronave	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
1-m		NjN-01-III-0488-26		Prodhim i asortimenteve të kripura	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
1-n		NjN-01-III-0489-26		Prodhim i asortimenteve të ëmbla	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
1-o		NjN-01-III-0490-26		Prodhim i petëve dhe produkteve tradicionale	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
1-p		NjN-01-III-0491-26		Menaxhimi i mbetjeve	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
1-q		NjN-24-III-0492-26		Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
2	A1-V-14	A1-V-26	Kontroll laboratorik i ushqimit		Program pas i mesëm 1-vjeçar studimi	Laborant të produkteve ushqimore	3119.03	I plotë	5
2-a		NjN-01-V -0459-26		Njohuri bazë mbi teknologjinë e prodhimit të produkteve ushqimore dhe laboratorit	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	5
2-b		NjN-01-V -0460-26		Planifikimi dhe organizimi i punës në kontrollin laboratorik të ushqimit	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	5
2-c		NjN-01-V -0461-26		Mjetet dhe pajisjet e punës në një laborator	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	5
2-d		NjN-01-V -0462-26		Pranimi i mostrës në laboratorë sipas llojit të produktit ushqimor	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	5
2-e		NjN-01-V -0463-26		Analizimi i mostrës në laboratorë sipas llojit të produktit ushqimor	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	5
2-f		NjN-01-V -0464-26		Sigurimi i cilësisë në laboratorë të produktit ushqimor	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	5
2-g		NjN-23-V-0111-24		Sipërmarrje dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	5
2-h		NjN-22-V-0130-24		Komunikimi dhe etika profesionale	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	5
2-i		NjN-01-V -0465-26		Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në laboratorë	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	5
3		C3-III-26	Mobilieri dhe tapiceri		Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Mobilier – Tapicier	7522.06/7522.28	I plotë	3
3-a		NjN-03-III-0552-26		Klasifikimi dhe dizajni i mobilie	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
3-b		NjN-03-III-0553-26		Parapërgatitja për prodhimin e produktit	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
3-c		NjN-03-III-0554-26		Planifikimi dhe organizimi i vendit të punës në mobilieri dhe tapiceri	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3
3-d		NjN-03-III-0555-26		Materialet për prodhimin e mobilie	Kualifikim i të nxënës gjatë të gjithë jetës			I pjeshtë	3



3-e	NjN-03-III-0556-26		Mjetet, pajisjet dhe teknikat e përdorimit të tyre	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
3-f	NjN-03-III-0557-26		Makinertë dhe përdorimi i tyre	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
3-g	NjN-03-III-0558-26		Teknologjia e prodhimit të mobilieve	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
3-h	NjN-03-III-0559-26		Punime të strukturës mbajtëse dhe të pjesës së butë në mobilet e tapicuara	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
3-i	NjN-03-III-0560-26		Riparimi i defekteve dhe restaurimi i mobilieve	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
3-j	NjN-24-III-0492-26		Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
3-k	NjN-03-III-0561-26		Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në mobilitet dhe tapiceri	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
4	D5-III-26	Rrobaqepësi		Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Rrobaqepës	7531	I plotë	3
4-a	NjN-04-III-0574-26		Estetika e veshjes	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
4-b	NjN-04-III-0575-26		Planifikimi dhe organizimi i punës në rrobaqepësi	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
4-c	NjN-04-III-0576-26		Mjetet, pajisjet e punës dhe përdorimi i tyre në rrobaqepësi	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
4-d	NjN-04-III-0577-26		Materialet tekstile	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
4-e	NjN-04-III-0578-26		Vizatimi i modeleve të thjeshta	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
4-f	NjN-04-III-0579-26		Bazat e prerjes	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
4-g	NjN-04-III-0580-26		Bazat e qepjes	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
4-h	NjN-04-III-0581-26		Teknikat e qepjes së veshjeve bazë për gra	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
4-i	NjN-04-III-0582-26		Teknikat e qepjes së veshjeve bazë për burra	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
4-j	NjN-04-III-0583-26		Teknikat e qepjes së veshjeve bazë për fëmijë	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
4-k	NjN-04-III-0584-26		Aksesorët dhe dekorimi i veshjeve	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
4-l	NjN-24-III-0492-26		Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
4-m	NjN-04-III-0585-26		Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në rrobaqepësi	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
5	E9-III-26	Instalime elektrike civile dhe industriale		Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Elektrici në banesa dhe të tjerë të ngjashëm	7411	I plotë	3
5-a	NjN-05-III-0504-26		Planifikimi dhe organizimi i punës në instalimet elektrike civile dhe industriale	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
5-b	NjN-05-III-0505-26		Bazat e elektroteknikës në instalime civile dhe industriale	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
5-c	NjN-05-III-0506-26		Teknologjia elektrike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
5-d	NjN-05-III-0507-26		Matje elektrike dhe elektronike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
5-e	NjN-05-III-0508-26		Vizatim teknik në instalime civile dhe industriale	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
5-f	NjN-05-III-0509-26		Furnizimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
5-g	NjN-05-III-0510-26		Teknika e sigurimit në implantet elektrike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
5-h	NjN-05-III-0511-26		Bazat e elektronikës në instalime civile dhe industriale	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
5-i	NjN-05-III-0512-26		Proceset e automatizuara	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
5-j	NjN-05-III-0513-26		Makinat elektrike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
5-k	NjN-05-III-0514-26		Prodhim i energjisë elektrike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
5-l	NjN-05-III-0515-26		Implante elektrike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
5-m	NjN-05-III-0516-26		Mirëmbajtje dhe riparime të implantit elektrik	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
5-n	NjN-24-III-0492-26		Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
5-o	NjN-05-III-0517-26		Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në instalime civile dhe industriale	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
6	E10-III-26	Instalime dhe mirëmbajtje të linjave të tensionit të ulët, tensionit të		Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Instalues dhe mirëmbajtës i linjave të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë	7413	I plotë	3



			mesëm dhe tensionit të lartë						
6-a		NjN-05-III-0493-26		Bazat e elektroteknikës në TU, TM dhe TL	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
6-b		NjN-05-III-0494-26		Sistemi energjetik	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
6-c		NjN-05-III-0495-26		Vizatimi teknik në sistemin elektrik	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
6-d		NjN-05-III-0496-26		Pajisjet, mjetet dhe materialet e punës në TU, TM dhe TL	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
6-e		NjN-05-III-0497-26		Instalimi i rrjetit të tensionit të ulët dhe të mesëm	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
6-f		NjN-05-III-0498-26		Instalimi i rrjetit të linjave të tensionit të lartë	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
6-g		NjN-05-III-0499-26		Instalimi i rrjetit të tensionit të lartë në nënstacionin elektrik	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
6-h		NjN-05-III-0500-26		Instalimi i kabinës elektrike	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
6-i		NjN-05-III-0501-26		Sistemi i matjes së energjisë elektrike	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
6-j		NjN-05-III-0502-26		Mirëmbajtja e rrjetit të TU-TM-TL	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
6-k		NjN-24-III-0492-26		Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
6-l		NjN-05-III-0503-26		Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në TU, TM dhe TL	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
7		G4-V-26	Shërbime mikpritjeje dhe turizmi		Program pas i mesëm 1-vjeçar studimi	Menaxher në agjenci udhëtimi	1439.01/4224.07	I plotë	5
7-a		NjN-07-V-0630-26		Planifikimi dhe organizimi i punës në shërbime mikpritjeje dhe turizmi	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	5
7-b		NjN-07-V-0631-26		Studimi i tregut dhe marketingu	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	5
7-c		NjN-07-V-0632-26		Blerja dhe shitja për ofrimin e shërbimeve të mikpritjes dhe turizmit	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	5
7-d		NjN-07-V-0633-26		Krijimi i produkteve dhe paketave për shërbimet e mikpritjes dhe turizmit	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	5
7-e		NjN-07-V-0634-26		Turizmi i qëndrueshëm në shërbimet e mikpritjes dhe turizmit	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	5
7-f		NjN-07-V-0635-26		Menaxhimi i risikut në shërbimet e mikpritjes dhe turizmit	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	5
7-g		NjN-23-V-0111-24		Sipërmarrja dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	5
7-h		NjN-22-V-0130-24		Komunikimi dhe etika profesionale	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	5
8		L/4-IV-26	Administrim zyre		Program 4-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Nëpunës zyre	4110	I plotë	4
8-a		NjN-11-IV-0466-26		Planifikimi dhe organizimi i ndërmarrjes	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
8-b		NjN-11-IV-0467-26		Bazat e së drejtës	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
8-c		NjN-11-IV-0468-26		Bazat e ekonomisë	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
8-d		NjN-11-IV-0469-26		Administrimi i korrespondencës	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
8-e		NjN-11-IV-0470-26		Shkrimi dhe administrimi i dokumenteve	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
8-f		NjN-11-IV-0471-26		Bazat e logistikës	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
8-g		NjN-11-IV-0472-26		Organizimi i veprimtarive	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
8-h		NjN-11-IV-0473-26		Administrimi i bazës së të dhënave	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
8-i		NjN-11-IV-0474-26		Garantimi i cilësisë së veprimtarive	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
8-j		NjN-22-IV-0006-24		Komunikimi dhe etika profesionale	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
8-k		NjN-11-IV-0475-26		Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në administrim zyre	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
9		M8-III-26	Mekanikë bujqësore		Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Mekanik për makineri bujqësore	7233.03	I plotë	3
9-a		NjN-12-III-0536-26		Makinëritë bujqësore, pajisjet ndihmëse dhe ndërtimi i tyre	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
9-b		NjN-12-III-0537-26		Skemat kinematike, hidraulike, pneumatike, elektrike, elektronike në mjetet bujqësore	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
9-c		NjN-12-III-0538-26		Bazat e mekanikës për mjetet bujqësore	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
9-d		NjN-12-III-0539-26		Bazat e elektroteknikës për mjetet bujqësore	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3



9-e	NjN-12-III-0540-26		Planifikimi dhe organizimi i punës në mekanikën bujqësore	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
9-f	NjN-12-III-0541-26		Diagnostikim i parregullsive në sistemet e makinerive bujqësore	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
9-g	NjN-12-III-0542-26		Punime saldimi dhe axhusterie në makineritë bujqësore	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
9-h	NjN-12-III-0543-26		Punime në motorët e makinerive bujqësore	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
9-i	NjN-12-III-0544-26		Punime në sistemin e transmetimit të fuqisë në makineritë bujqësore	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
6-j	NjN-12-III-0545-26		Punime në sistemin e drejtimit të makinerive bujqësore	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
9-k	NjN-12-III-0546-26		Punime në sistemin e frenimit të makinerive bujqësore	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
9-l	NjN-12-III-0547-26		Punime në sistemin e varjes dhe të ecjes së makinerive bujqësore	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
9-m	NjN-12-III-0548-26		Punime në sistemin hidraulik dhe pneumatik të makinerive bujqësore	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
9-n	NjN-12-III-0549-26		Punime në sistemet elektrike dhe elektronike në makineritë bujqësore	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
9-o	NjN-12-III-0550-26		Punime në pajisjet ndihmëse të makinerive bujqësore	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
9-p	NjN-24-III-0492-26		Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
9-q	NjN-12-III-0551-26		Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në mekanikën bujqësore	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
10	M/1-IV-26	Riparime dhe mirëmbajtje automjeteve		Program 4-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Riparues dhe mirëmbajtës të automjeteve	7231	I plotë	4
10-a	NjN-12-IV-0518-26		Planifikimi dhe organizimi i punës në riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-b	NjN-12-IV-0519-26		Vizatim teknik në shërbime mjeteve transporti	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-c	NjN-12-IV-0520-26		Njohuri për mjetet e transportit	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-d	NjN-12-IV-0521-26		Bazat e mekanikës	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-e	NjN-12-IV-0522-26		Shërbime mirëmbajtjeje në automjete	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-f	NjN-12-IV-0523-26		Diagnostikimi i automjeteve	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-g	NjN-12-IV-0524-26		Shërbime me motorët e automjeteve	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-h	NjN-12-IV-0525-26		Shërbime në sistemet e furnizimit me ajër dhe shkarkimit të produkteve të djegies së motorit	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-i	NjN-12-IV-0526-26		Shërbime në sistemin e transmetimit të fuqisë dhe lëvizjes në automjete	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-j	NjN-12-IV-0527-26		Shërbime në sistemin e frenimit	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-k	NjN-12-IV-0528-26		Shërbime në sistemin e drejtimit	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-l	NjN-12-IV-0529-26		Shërbime në sistemin e varjes (suspension) dhe të ecjes	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-m	NjN-12-IV-0530-26		Shërbime në sistemet elektrike dhe elektronike	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-n	NjN-12-IV-0531-26		Shërbime në sistemin e sigurisë aktive dhe pasive	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-o	NjN-12-IV-0532-26		Shërbime në sistemet ndihmëse	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-p	NjN-12-IV-0533-26		Sistemi i ftohjes dhe i ngrohjes (HVAC) në kabinën e automjeteve	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-q	NjN-12-IV-0534-26		Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
10-r	NjN-24-IV-0535-26		Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11	M/2-IV-26	Shërbime në automjete elektrike dhe hibride		Program 4-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Riparues dhe mirëmbajtës i automjeteve elektrike dhe hibride	7231	I plotë	4
11-a	NjN-12-IV-0618-26		Planifikimi dhe organizimi i punës për shërbime në automjetet elektrike dhe hibride	Kualifikim i të nxënit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4



11-b		NjN-12-IV-0519-26		Vizatim teknik në shërbime mjtesh transporti	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-c		NjN-12-IV-0520-26		Njohuri për mjetet e transportit	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-d		NjN-12-IV-0521-26		Bazat e mekanikës	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-e		NjN-12-IV-0619-26		Njohuri mbi automjetet elektrike dhe hibride	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-f		NjN-12-IV-0620-26		Sistemet e tensionit të lartë dhe shërbimet e tyre në automjetet elektrike dhe hibride	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-g		NjN-12-IV-0621-26		Sistemi i menaxhimit të ruajtjes dhe kontrollit të energjisë elektrike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-h		NjN-12-IV-0622-26		Sistemet e ftohjes dhe ngrohjes në automjetet elektrike dhe hibride	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-i		NjN-12-IV-0522-26		Shërbime mirëmbajtjeje në automjetet	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-j		NjN-12-IV-0623-26		Diagnostikimi i automjeteve elektrike dhe hibride	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-k		NjN-12-IV-0624-26		Shërbime në motorët me djegie të brendshme të automjeteve	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-l		NjN-12-IV-0525-26		Shërbime në sistemet e furnizimit me ajër dhe shkarkimit të produkteve të djegies së motorit	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-m		NjN-12-IV-0526-26		Shërbime në sistemin e transmetimit të fuqisë dhe lëvizjes në automjetet	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-n		NjN-12-IV-0625-26		Shërbime në sistemin e frenimit në automjetet elektrike dhe hibride	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-o		NjN-12-IV-0528-26		Shërbime në sistemin e drejtimit	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-p		NjN-12-IV-0529-26		Shërbime në sistemin e varjes (<i>suspension</i>) dhe të ecjes	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-q		NjN-12-IV-0626-26		Sistemi i prodhimit dhe transmetimit të fuqisë në komponentët e tensionit të lartë tek automjetet elektrike dhe hibride	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-r		NjN-12-IV-0627-26		Shërbime në sistemet elektrike dhe elektronike, si dhe në sistemet e tjera të tensionit të ulët në automjetet EV dhe HEV	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-s		NjN-12-IV-0531-26		Shërbime në sistemin e sigurisë aktive dhe pasive	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-t		NjN-12-IV-0532-26		Shërbime në sistemet ndihmëse	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-y		NjN-12-IV-0628-26		Shërbime në sistemin AC në automjetet elektrike dhe hibride	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-u		NjN-24-IV-0535-26		Sipërmarrje dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
11-v		NjN-12-IV-0629-26		Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit për shërbime në automjetet elektrike dhe hibride	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
12		T/5-IV-26	Rrjete të dhënash dhe sisteme kompjuterike		Program 4-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Teknikë të rrjetit kompjuterik dhe sistemeve	3513	I plotë	4
12-a		NjN-19-IV-0562-26		Bazat e TIK-ut në rrjete të dhënash dhe sisteme kompjuterike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
12-b		NjN-19-IV-0563-26		Programim në rrjete	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
12-c		NjN-19-IV-0564-26		Sistemet kompjuterike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
12-d		NjN-19-IV-0565-26		Planifikimi dhe organizimi i punës në rrjete të dhënash dhe sisteme kompjuterike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
12-e		NjN-19-IV-0566-26		Identifikimi i infrastrukturës së rrjetit	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
12-f		NjN-19-IV-0567-26		Instalimi dhe konfigurimi i rrjetit	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
12-g		NjN-19-IV-0568-26		Mirëmbajtje dhe riparime të rrjeteve dhe sistemeve kompjuterike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
12-h		NjN-19-IV-0569-26		Siguria kibernetike në rrjete të dhënash dhe sisteme kompjuterike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
12-i		NjN-19-IV-0570-26		Dokumenti i punës në rrjet dhe në sisteme	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
12-j		NjN-19-IV-0571-26		Administrimi i sistemeve kompjuterike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
12-k		NjN-25-IV-0572-26		Sipërmarrje, komunikim, edukim për të drejtat në mjedisin digital dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4



12-l		NjN-19-IV-0573-26		Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në rrjete të dhënash dhe sisteme kompjuterike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	4
13		V4-III-26	Instalime hidraulike		Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Hidraulikë në banesa	7126	I plotë	3
13-a		NjN-20-III-0598-26		Bazat e hidraulikës	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
13-b		NjN-20-III-0599-26		Planifikimi dhe organizimi i punës për instalimet hidraulike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
13-c		NjN-20-III-0600-26		Njohuri për ndërtesat	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
13-d		NjN-20-III-0601-26		Vizatim teknik në termohidraulikë	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
13-e		NjN-20-III-0602-26		Punime përgatitore për instalimet hidraulike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
13-f		NjN-20-III-0603-26		Teknologjia e materialeve	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
13-g		NjN-20-III-0604-26		Mirëmbajtje dhe riparime hidraulike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
13-h		NjN-20-III-0605-26		Sisteme me panele diellore	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
13-i		NjN-20-III-0606-26		Instalime rrjetesh hidraulike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
13-j		NjN-20-III-0607-26		Instalim pajisjesh hidro-santare	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
13-k		NjN-20-III-0608-26		Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në instalimet hidraulike	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
13-l		NjN-24-III-0492-26		Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
14		V5-III-26	Instalime të sistemeve ngrohëse-ftohëse		Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Instalues i sistemeve ftohëse-ngrohëse	7127	I plotë	3
14-a		NjN-20-III-0609-26		Bazat e termohidraulikës	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
14-b		NjN-20-III-0601-26		Vizatim teknik në termohidraulikë	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
14-c		NjN-20-III-0610-26		Planifikimi dhe organizimi i punimeve për instalimin e sistemeve ngrohëse-ftohëse	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
14-d		NjN-20-III-0600-26		Njohuri për ndërtesat	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
14-e		NjN-20-III-0611-26		Punime përgatitore për instalimin e sistemeve ngrohëse-ftohëse	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
14-f		NjN-20-III-0612-26		Sistemet e ngrohjes	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
14-g		NjN-20-III-0613-26		Sistemet e ajrit të kondicionuar (HVAC)	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
14-h		NjN-20-III-0614-26		Sistemet e ventilimit	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
14-i		NjN-20-III-0615-26		Instalimi i pajisjeve të brendshme të sistemeve ngrohëse-ftohëse	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
14-j		NjN-20-III-0616-26		Mirëmbajtje dhe riparime të sistemeve ngrohëse-ftohëse	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
14-k		NjN-20-III-0603-26		Teknologjia e materialeve	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
14-l		NjN-24-III-0492-26		Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
14-m		NjN-20-III-0617-26		Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në instalimin e sistemeve ngrohëse-ftohëse	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
15		V6-III-26	Shërbime hidraulike në ujësjellës-kanalizime		Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Hidraulikë në ujësjellës-kanalizime	7126	I plotë	3
15-a		NjN-20-III-0586-26		Bazat e hidraulikës në ujësjellës-kanalizime	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
15-b		NjN-20-III-0587-26		Bazat e topografisë	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
15-c		NjN-20-III-0588-26		Materialet në hidraulikë	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
15-d		NjN-20-III-0589-26		Mjetet, veglat, pajisjet dhe makineritë e punës në hidraulikë	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
15-e		NjN-20-III-0590-26		Planifikimi dhe organizimi i punës në ujësjellës-kanalizime	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
15-f		NjN-20-III-0591-26		Operimi dhe mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë dhe hidrantëve	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
15-g		NjN-20-III-0592-26		Instalimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe hidrantëve	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
15-h		NjN-20-III-0593-26		Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
15-i		NjN-20-III-0594-26		Instalimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura	Kualifikim i të nxënitorit gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3



15-j		NjN-20-III-0595-26		Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujërave të shiut	Kualifikim i të nxënësve gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
15-k		NjN-20-III-0596-26		Instalimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut	Kualifikim i të nxënësve gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
15-l		NjN-24-III-0492-26		Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënësve gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3
15-m		NjN-20-III-0597-26		Sigura në punë dhe mbrojtja e mjedisit në ujësjellës-kanalizime	Kualifikim i të nxënësve gjatë të gjithë jetës			I pjesshëm	3

URDHËR

Nr. 551, datë 17.7.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z. Lavdrim Sahitaj, Sekretar i Përgjithshëm:

a) të nënshkruajë autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e gjykimit, duke përfshirë kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjykimit të kësaj çështjeje, si edhe t'i nënshkruajë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga z. Lavdrim Sahitaj, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit;

b) të nënshkruajë autorizimin e importit për barna narkotike/lëndë psikotrope anglisht/shqip, që i dërgohet paraprakisht vendit eksportues; autorizimin e importit për zhdoganimin e barnave narkotike; autorizimin e importit për zhdoganimin e lëndëve psikotrope; autorizimin e eksportit për barna narkotike/lëndë psikotrope anglisht/shqip, që i dërgohet paraprakisht vendit importues;

autorizimin individual të importit/eksportit për lëndët e kategorisë 1/2 anglisht/shqip që i dërgohet paraprakisht vendit eksportues/importues; autorizimin e importit për prekursorët; autorizimin e importit për barnat e paautorizuara; autorizimin e importit për barnat e dhuruara (dhe/ose kryerjen e provave klinike); autorizim për tregtimin me shumicë, pakicë dhe/ose prodhimin e barnave narkotike dhe lëndëve psikotrope; certifikatë regjistrimi për importim, eksportim, ruajtje dhe tregtim me shumicë të prekursorëve të drogës të kategorisë 3;

c) nënshkruan urdhrat për rinovim/revokim/pajisje me autorizim për tregtim të barnave;

d) delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore dhe të huaja për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

e) delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për procedurat e koncesioneve dhe partneritetin publik privat me fonde buxhetore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

f) të ndjek procedurat për ngritjen, monitorimin dhe raportimin e grupeve të punës për nevoja të institucionit;

g) të nënshkruajë autorizimet për dërgim me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale jashtë qendrës së punës, brenda vendit të punës, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit;

h) të nënshkruajë ankimet administrative drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

i) të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon ministrit;

j) të ndjekë procedurat e lidhjes së marrëveshjeve të posaçme (MEA), për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;



k) të nënshkruajë aktet që rregullojnë marrëdhëniet e punës për punonjësit administrativë të ministrisë;

l) të nënshkruajë urdhrin për dërgimin me shërbim jashtë vendit, të punonjësve të institucioneve të varësisë;

m) të vlerësojë dhe miratojë kërkesat për transferimin e personelit mjekësor në institucionet e kujdesit shëndetësor;

n) të vlerësojë dhe miratojë kërkesat për vazhdimin e marrëdhënies së punësimit, përtej moshës së përcaktuar për përfitimin e pensionit të pleqërisë, për personelin mjekësor në institucionet e kujdesit shëndetësor;

o) të vlerësojë kërkesat për kontraktimin e përkohshëm të mjekëve jashtë organikës, në institucionet e kujdesit shëndetësor;

p) të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhr nga ministri.

2. Këto kompetenca të ushtrohen nga z. Lavdrim Sahitaj, Sekretar i Përgjithshëm, duke filluar nga data 17.7.2026.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues ose të deleguar.

4. Ngarkohet z. Lavdrim Sahitaj, Sekretar i Përgjithshëm, dhe të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij urdhri.

5. Urdhri “Për delegim kompetence” nr. 614/1, datë 18.12.2025, shfuqizohet.

Ky urdhr hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MIRËQENIES SOCIALE
Evis Sala

URDHËR
Nr. 741, datë 16.7.2026

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE
PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË
MURTAJËS SË RUMINANTËVE
TË VEGJËL**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të shkronjës “b”, të pikës 1 dhe pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për

shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të ruminatëve të vegjël në tregjet e kafshëve të gjalla, panairë dhe grumbullime të tjera në qarkun Vlorë.

2. Ndalimin e lëvizjes së ruminantëve të vegjël dhe specieve të tjera të mbarështuara nga ferma në fermë në zonën e mbrojtur dhe zonën e mbikëqyrjes.

3. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të ruminantëve të vegjël dhe inventarizimin e tyre në zonën e mbrojtur dhe zonën e mbikëqyrjes.

4. Forcimin e masave të biosigurisë.

5. Kafshët e llojit të imta duhet të mbarështohen sipas kërkesave shëndetësore të mbarështimit të tyre, si dhe të jenë të izoluara nga kafshët e tjera në fermë dhe të kufizohet kontakti me kafshët e tjera.

6. Intensifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit të fermerëve, transportuesve të kafshëve, veterinerëve privat dhe shërbimit veterinar shtetëror.

7. Intensifikimin e mbikëqyrjes dhe kontrollit veterinar në fermat që mbarështojnë ruminantë të vegjël dhe tregjet e kafshëve të gjalla, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

8. Masat e sipërcituara nga pika 2 deri në pikën 6, zbatohen në territorin e:

Nr.	Njësia Administrative	Fshati
3 km		
1	Brataj	Lepenicë
2	Brataj	Gjorm
10 km		
3	Brataj	Velçë
4	Brataj	Malas
5	Brataj	Brataj
6	Brataj	Mesaplik
7	Hore-Vranisht	Tërbaç
8	Hore-Vranisht	Vranisht
9	Kotë	Gumenicë
10	Kotë	Vajzë
11	Sevaster	Ploçë
12	Orikum	Dukat Fshat



9. Zbatimin e masave të tjera të përmendura në urdhrin nr. 802, datë 9.10.2024, “Për miratimin e planit kombëtar të kontigjencës për sëmundjen e murtajës së ruminantëve të vegjël (PPR)”.

10. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdher hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR

Nr. 745, datë 17.7.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E KROACISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Osjecko-Baranjska	Durđenovac*	

Osjecko-Baranjska	Draž*	
Osjecko-Baranjska	Drenje*	
Osjecko-Baranjska	Erdut*	
Osjecko-Baranjska	Kneževi Vinogradi*	
Osjecko-Baranjska	Magadenovac*	
Osjecko-Baranjska	Našice*	
Osjecko-Baranjska	Osijek*	
Osjecko-Baranjska	Viljevo*	
Viroviticko-Podravski	Crnac*	
Viroviticko-Podravski	Zdenci*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Kroacisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të



Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të

cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vlarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose



c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të

shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 739, datë 16.7.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin Kroacisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 746, datë 17.7.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË SHTETIN E SPANJËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë*
Aragón	Huesca	Boltaña*
Cataluña	Girona	Pla de l'estany (banyoles)*
Castilla - La Mancha	Toledo	Galvez*
Castilla - La Mancha	Toledo	Toledo*
Castilla - La Mancha	Toledo	Oropesa*
Comunidad Foral de Navarra	Navarra	Ochagavía*
País Vasco	Gipuzkoa	Gipuzkoa*
Illes Balears	Illes Balears	Palma*
Illes Balears	Illes Balears	Menorca*
Galicia	A Coruña	Ferrol*
Galicia	A Coruña	A Barcala*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj

periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;



v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinarë shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 740, datë 16.7.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 750, datë 20.7.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË MBRETËRINË E
BASHKUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
England	Barnsley	Barnsley*
England	Bath and North East Somerset	Bath and North East Somerset*
England	Buckinghamshire	Buckinghamshire*
England	Bournemouth, Christchurch and Poole	Bournemouth, Christchurch and Poole*



England	Bracknell Forest	Bracknell Forest*
England	Bradford	Bradford*
England	Calderdale	Calderdale*
England	Cambridgeshire	East Cambridgeshire*
England	Cambridgeshire	South Cambridgeshire*
England	Central Bedfordshire	Central Bedfordshire*
England	Cheshire East	Cheshire East*
England	Cheshire West and Chester	Cheshire West and Chester*
England	Cornwall	Cornwall*
England	Cumberland	Cumberland Council*
England	Derbyshire	Amber Valley*
England	Derbyshire	Bolsover*
England	Derbyshire	Derbyshire Dales*
England	Derbyshire	High Peak*
England	Derbyshire	North Derbyshire* East
England	Devon	East Devon*
England	Devon	Mid Devon*
England	Devon	North Devon*
England	Devon	Teignbridge*
England	Devon	South Hams*
England	Devon	West Devon*
England	Dorset	Dorset*
England	Doncaster	Doncaster*
England	Gloucestershire	Stroud*
England	Gloucestershire	Cotswold*
England	East Riding of Yorkshire	East Riding of Yorkshire*
England	East Sussex	Rother*
England	East Sussex	Lewes*
England	East Sussex	Wealden*
England	Essex	Braintree*
England	Essex	Brentwood*
England	Essex	Chelmsford*
England	Essex	Colchester*
England	Essex	Epping Forest*
England	Essex	Maldon*
England	Essex	Harlow*
England	Essex	Tendring*
England	Greater London	Harrow*
England	Herefordshire, County of	Herefordshire, County of*
England	Hertfordshire	Dacorum*
England	Hertfordshire	East Hertfordshire*
England	Hertfordshire	Hertsmerc*
England	Hertfordshire	Three Rivers*
England	Medway	Medway*
England	Milton Keynes	Milton Keynes*
England	Shropshire	Shropshire*
England	Kent	Ashford*
England	Kent	Canterbury*
England	Kent	Dover*
England	Kent	Gravesham*
England	Kent	Folkestone and Hythe*
England	Kent	Maidstone*
England	Kent	Sevenoaks*
England	Kent	Swale*
England	Kent	Tonbridge and Malling*
England	Kent	Tunbridge Wells*
England	Kirklees	Kirklees*

England	Isle of Wight	Isle of Wight*
England	Somerset	Somerset Council*
England	Suffolk	East Suffolk*
England	Suffolk	Babergh*
England	Suffolk	Mid Suffolk*
England	Suffolk	Waverley*
England	Suffolk	West Suffolk*
England	Surrey	Guildford*
England	Surrey	Runnymede*
England	Hampshire	Basingstoke and Deane*
England	Hampshire	East Hampshire*
England	Hampshire	Eastleigh*
England	Hampshire	Hart*
England	Hampshire	Test Valley*
England	Hampshire	New Forest*
England	Hampshire	Winchester*
England	Lancashire	Chorley*
England	Lancashire	Hyndburn*
England	Lancashire	Lancaster*
England	Lancashire	Ribble Valley*
England	Lancashire	Wyre*
England	Leicestershire	Charnwood*
England	Leicestershire	Harborough*
England	Leicestershire	Hinckley and Bosworth*
England	Leicestershire	North Leicestershire* West
England	Lincolnshire	East Lindsey*
England	Lincolnshire	West Lindsey*
England	Lincolnshire	South Kesteven*
England	Staffordshire	East Staffordshire*
England	Staffordshire	Newcastle-under-Lyme*
England	Staffordshire	Stafford*
England	Staffordshire	Staffordshire Moorlands*
England	Staffordshire	South Staffordshire*
England	Southampton	Southampton*
England	South Gloucestershire	South Gloucestershire*
England	Stockport	Stockport*
England	Norfolk	Breckland*
England	Norfolk	Broadland*
England	Norfolk	Great Yarmouth*
England	Norfolk	King's Lynn and West Norfolk*
England	Norfolk	South Norfolk*
England	Norfolk	North Norfolk*
England	North Yorkshire	North Yorkshire Council*
England	Nottinghamshire	Bassetlaw*
England	Nottinghamshire	Newark and Sherwood*
England	Oxfordshire	South Oxfordshire*
England	Oxfordshire	Vale of White Horse*
England	Tameside	Tameside*
England	Trafford	Trafford*
England	Thurrock	Thurrock*
England	York	York*
England	West Berkshire	West Berkshire*
England	Wiltshire	Wiltshire*
England	Wokingham	Wokingham*



England	Westmorland and Furness Council	Westmorland and Furness Council*
England	West Sussex	Arun*
England	West Sussex	Chichester*
England	West Sussex	Horsham*
England	West Sussex	Mid Sussex*
Isle of Man	Glenfaba	Patrick*
Isle of Man	Middle	Braddan*
Isle of Man	Rushen	Arbory*
Isle of Man	Rushen	Rushen*
United Kingdom Exclusive Economic Zone	Brightlingsea*	
United Kingdom Exclusive Economic Zone	Middleton*	
Wales	Ceredigion	Ceredigion*
Wales	Denbighshire	Denbighshire*
Wales	Monmouthshire	Monmouthshire*
Wales	Powys	Powys*
Wales	Wrexham	Wrexham*
Northern Ireland	North Down and Ards	Ards*
Northern Ireland	Ards and North Down	North Down*
England	Wakefield	Wakefield*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve

Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe



ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinarë shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 695, datë 3.7.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i

Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR Nr. 751, datë 20.7.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
1.	Kansas	Pratt*
2.	Texas	Shelby*
3.	Indiana	Elkhart*
4.	Indiana	Noble*
5.	Indiana	LaGrange*
6.	Arkansas	Clay*
7.	South Dakota	Edmunds*



8.	New Jersey	Hunterdon*
9.	North Dakota	Dickey*
10.	Minnesota	Becker*
11.	Utah	Cache*
12.	Idaho	Canyon*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 723, datë 13.7.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

VENDIM Nr. 181, datë 6.7.2026

MBI PEZULLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DRINI BULQIZË” SHPK PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TE SHOQËRIA “HEC POLEMI” SHPK

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1005/7 prot., datë 6.7.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Drini Bulqizë’ sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike te shoqëria ‘HEC Polemi’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 577, seria P24, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.4.2024, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 mw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës mbi tre degëzimet e Përroit të Neshtës, degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan, për një afat 30-vjeçar.

- Në vijim të aplikimit të shoqërisë, të depozituar në ERE me shkresën e protokolluar me nr. 1005 prot., datë 30.3.2026, si dhe dokumentacionit plotësues të administruar me shkresën nr. 1005/1 prot., datë 7.4.2026, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 117, datë 24.4.2026, vendosi fillimin e procedurës



administrative për shqyrtimin e kërkesës për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k., si dhe fillimin e procedurës për dhënien e autorizimit për transferimin e aseteve fikse të centralit hidroelektrik “Polemi”.

- Për vendimin si më sipër, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 1005/4 prot., datë 7.5.2026, duke i kërkuar të bëjë me dije nëse ka një qëndrim ndryshe në lidhje me transferimin e licencës dhe aseteve të shoqërisë.

- Në përgjigje të kësaj kërkesë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1005/7 prot., datë 28.5.2026, bëri me dije se kërkesa e shoqërisë për miratimin e ristrukturimit organizativ/transferimit të aktivitetit ishte ende në proces shqyrtimi. Njëkohësisht, ministria evidentoi se, në përputhje me parashikimet e kontratës së lidhur me mbajtësin e miratimit, për çdo transferim të aksioneve ose të kapitalit themeltar tek të tretët kërkohet pëlqimi paraprak i saj.

- Me qëllim sqarimin e natyrës së procedurës administrative të zhvilluar në ERE, kjo e fundit, me shkresën nr. 1005/9 prot., datë 4.6.2026, i kërkoj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të shprehet posaçërisht mbi kërkesën për transferimin e licencës dhe të aseteve, duke sqaruar se procedura objekt shqyrtimi nuk lidhet me ndryshimin e ortakëve të shoqërisë, por me transferimin e licencës dhe të aseteve të saj, ndërsa çdo qëndrim i ministrisë do të merrej në konsideratë gjatë vlerësimit përfundimtar të kërkesës.

- Paralelisht me korrespondencën institucionale, gjatë shqyrtimit të aplikimit u konstatua nevoja për plotësimin e dokumentacionit shtesë, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1005/10 prot., datë 4.6.2026, duke kërkuar administrimin e dokumentacionit shtesë të nevojshëm për vijimin e procedurës.

- Duke qenë se, nuk ishte administruar ende qëndrimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria rezultonte ende i paplotë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 161, datë 5.6.2026, vendosi zgjatjen me 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes për shqyrtimin e kërkesës për transferimin e licencës dhe

për transferimin e aseteve të paluajtshme të HEC “Polemi”.

- Në vijim të kësaj procedure, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1005/11 prot., datë 10.6.2026, nr. 1005/12 prot., datë 11.6.2026, nr. 1005/14 prot., datë 25.6.2026, nr. 1005/15 prot., datë 26.6.2026 dhe *email*-in nr. 1005/16 prot., datë 29.6.2026, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues.

- Nga dokumentacioni i administruar rezulton, gjithashtu, se shoqëria, me shkresën e saj nr. 08/6 prot., datë 8.6.2026, i është drejtuar Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, në kuadër të transferimit të të drejtave të shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.

- Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 934/1 prot., datë 12.6.2026, AMBU-ja ka sqaruar shoqërinë se duhet të paraqesë aplikimin për transferimin e lejes për përdorim burimi ujor dhe të mbajë në konsideratë që të kryejë reflektimet përkatëse në kontratën e nënshkruar me MIE-n. Në vijim, me shkresën e datës 29.6.2026, shoqëria ka depozituar formularin e aplikimit për transferimin e lejes për përdorimin e burimit ujor të HEC “Polemit”, të nxjerrë nga sistemi *e-leje* dhe drejtuar AMBU-së.

- Nga verifikimi i dokumentacionit administrativ rezulton se, deri në datën e shqyrtimit të kësaj çështjeje nga Bordi i ERE-s, nuk është administruar ende qëndrimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, lidhur me kërkesën e paraqitur nga shoqëria, ndërsa nuk ishte depozituar as shtojca nr. 1, e kërkuar në kuadër të procedurës së transferimit të licencës.

Pezullimi i afatit të vendimmarrjes

- Në nenin 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë ose organ tjetër (çështja paraprake), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.”

- Po ashtu, në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e



licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në këtë procedurë rezulton se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka bërë me dije se kërkesa e shoqërisë për ristrukturimin organizativ/transferimin e aktivitetit vijon të jetë në shqyrtim. Po ashtu, ministria ka evidentuar se, sipas marrëdhënies kontraktore të krijuar ndërmjet palëve, për transferimin e aksioneve ose të kapitalit themeltar tek të tretët kërkohet pëlqimi paraprak i saj.

- Nga ana tjetër, rezulton se shoqëria ka filluar edhe procedurën administrative për transferimin e lejes për përdorimin e burimit ujor pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, procedurë e cila, në momentin e shqyrtimit të kësaj çështjeje nga Bordi, nuk rezulton të ketë përfunduar.

- Bordi vëren se procedura administrative e zhvilluar në ERE ka për objekt transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike dhe autorizimin për transferimin e aseteve të paluajtshme të të licencuarit, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij. Për rrjedhojë, vlerësimi mbi kërkesën për transferimin e licencës është kompetencë ekskluzive e Bordit të ERE-s dhe ushtrohet në mënyrë të pavarur, bazuar në kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni sektorial. Megjithatë, ushtrimi i kësaj kompetence kërkon që Bordi të disponojë një tablo të plotë të rrethanave faktike dhe juridike që lidhen me kërkesën objekt shqyrtimi. Në këtë kuadër, procedurat administrative që vijojnë të zhvillohen pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore përbëjnë elemente të rëndësishme të cilat, ndonëse nuk zëvendësojnë kompetencën vendimmarrëse të ERE-s, janë të nevojshme për administrimin e plotë të provave dhe për garantimin e një vendimmarrjeje të bazuar në të gjitha rrethanat përkatëse të çështjes.

- Po kështu, rezulton se deri në këtë fazë të procedurës nuk është administruar ende qëndrimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë mbi kërkesën e shoqërisë, si dhe nuk është plotësuar i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga ERE, konkretisht shtojca nr. 1, e cila përbën pjesë të

dokumentacionit të domosdoshëm për përfundimin e shqyrtimit administrativ.

- Në këto kushte, bordi çmon se, në zbatim të nenit 14, pika 10, të rregullores së licencimit, si dhe duke mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit 66, të Kodit të Procedurave Administrative, ekzistojnë rrethana objektive që justifikojnë pezullimin e afatit të vendimmarrjes deri në administrimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe përfundimin e procedurave administrative që lidhen me kërkesën objekt shqyrtimi. Gjithashtu, duke qenë se neni 17, pika 5, i rregullores së licencimit parashikon se transferimi i licencës kryhet paralelisht me transferimin e aseteve fikse të të licencuarit, pezullimi i vendimmarrjes për transferimin e licencës sjell domosdoshmëri edhe pezullimin e vendimmarrjes lidhur me dhënien e autorizimit për transferimin e aseteve të paluajtshme të HEC “Polemi”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë afatin e vendimmarrjes për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për transferimin e licencës nr. 577, seria P24, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.4.2024, për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 mw, tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k., deri në administrimin e qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe plotësimin e dokumentacionit të kërkuar në kuadër të kësaj procedure administrative.

2. Të pezullojë afatin e vendimmarrjes për shqyrtimin e kërkesës për dhënien e autorizimit për transferimin e aseteve të paluajtshme të HEC “Polemi”, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k., deri në plotësimin e kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Shqyrtimi administrativ i kërkesës do të rifillojë pas administrimit të qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe plotësimit të dokumentacionit të kërkuar nga ERE, nëse ky dokumentacion rezulton ende i paplotë.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës ngarkohet me njoftimin e këtij vendimi shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., si dhe palëve të përfshira në këtë procedurë me ndjekjen e mëtejshme të procedurës administrative



deri në plotësimin e kushteve për vijimin e shqyrtimit të saj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 182, datë 6.7.2026

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SHPK PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TE SHOQËRIA “EZ5 TRADING” SHPK

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 13 dhe 17, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1613/7 prot., datë 3.7.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së tregtimit dhe asaj të furnizimit të energjisë elektrike te shoqëria ‘EZ5 Trading’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 438, seria T19/T23, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 7.3.2019, dhe të rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 289, datë 9.10.2023, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1613 prot., datë 18.5.2026, shoqëria në cilësinë e subjektit mbajtës të licencës ka depozituar aplikimin për transferimin e plotë të licencës së tregtimit të energjisë elektrike, te shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k., e cila do të administrojë dhe operojë këtë veprimtari.

- Në mbështetje të kësaj kërkesë dhe pas verifikimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 153, datë 28.5.2026, vendosi të fillojë procedurën për transferimin e licencës së tregtimit të shoqërisë.

- Në zbatim të kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.5.2026 dhe 1.6.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 8.6.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Brenda afatit të përcaktuar për paraqitjen e komenteve apo kundërshtimeve nga palët e interesuara nuk u administruan komente apo objeksione, lidhur me kërkesën objekt shqyrtimi, çka evidenton mungesën e pretendimeve nga palët e treta mbi procedurën e nisur.

- Në vijim të shqyrtimit të aplikimit, ERE konstatoi nevojën për plotësimin e dokumentacionit të paraqitur dhe me shkresën nr. 1613/3 prot., datë 11.6.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së transferimit të licencës, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikim për vijimin e procedurës.

- Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1613/4 prot., datë 16.6.2026, shoqëria depozitoi dokumentacion plotësues, nga analizimi i të cilit rezultoi se kishte ende dokumentacion që nevojitej të plotësohej, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë nëpërmjet shkresës me nr. 1613/5 prot., datë 24.6.2026.

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1613/6 prot., datë 30.6.2026, shoqëria depozitoi informacionin/dokumentacion e kërkuar, duke plotësuar dokumentacionin administrativ të nevojshëm për përfundimin e shqyrtimit të kërkesës.

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës administrative rezultoi se kërkesa e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. për transferimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike është paraqitur në përputhje me kërkesat procedurale të përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i



ndryshuar, si dhe në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar ku në përputhje me nenin 17, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave “a”, “b”, “c”, “d” dhe “f”.

- Në zbatim të nenit 17, të kësaj rregulloreje, aplikuesi ka depozituar dokumentacionin e kërkuar për procedurën e transferimit të licencës, ndërsa gjatë shqyrtimit administrativ ka plotësuar edhe dokumentacionin shtesë të kërkuar nga ERE, duke mundur administrimin e plotë të dosjes së aplikimit.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nuk rezultojnë mospërputhje me kërkesat e legjislacionit sektorial apo mangësi të tilla që të përbëjnë pengesë për vijimin dhe përfundimin e procedurës së transferimit të licencës.

- Rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Po ashtu, rezulton se shoqëria ka shlyer dhe pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Po ashtu, në përfundim të procedurës së njoftimit publik të fillimit të procedurës administrative nuk u administruan komente, kundërshtime apo pretendime nga palë të treta, të cilat të kërkonin verifikime shtesë ose të evidentonin rrethana që do të ndikonin në vlerësimin e kërkesës.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës administrative rezulton se janë përmbushur kërkesat ligjore dhe procedurale për shqyrtimin e kërkesës për transferimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike nga shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k. tek shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k.

- Procedura objekt shqyrtimi nuk përbën dhënie të një licence të re, por transferimin e një licence ekzistuese, në përputhje me nenin 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenin 17, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”. Për rrjedhojë, objekt i shqyrtimit të Bordit nuk është

rivlerësimi i nevojës për licencimin e kësaj veprimtarie, por verifikimi i përmbushjes së kushteve ligjore për transferimin e cilësisë së mbajtësit të licencës.

- Nga analiza e dokumentacionit të administruar, rezulton se shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, ndërsa gjatë procedurës administrative ka plotësuar edhe kërkesat e ERE-s për administrimin e dokumentacionit shtesë. Po ashtu, nuk rezultojnë rrethana ligjore ose procedurale që të përbëjnë pengesë për miratimin e transferimit të licencës.

- Bordi konstaton, gjithashtu, se gjatë procedurës së njoftimit publik, nuk janë paraqitur komente apo kundërshtime nga palë të treta, ndërsa nga verifikimet e kryera nuk rezultojnë detyrime të papërmbushura ndaj ERE-s që do të ndikonin në përfundimin e procedurës.

- Në vlerësim të dokumentacionit të administruar, Bordi çmon se transferimi i licencës nuk sjell ndryshim të objektit, përmbajtjes apo kushteve të licencës së miratuar, por vetëm ndryshimin e subjektit mbajtës të saj. Për rrjedhojë, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga licenca nr. 438, seria T19/T23, vijnë të ushtrohen dhe të përmbushen nga subjekti përfitues i transferimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e licencës së transferuar.

- Po kështu, Bordi vlerëson se miratimi i transferimit të licencës nuk cenon funksionimin normal të tregut të energjisë elektrike, nuk ndikon në ushtrimin e kompetencave rregullatore të ERE-s dhe nuk krijon rrethana që të pengojnë mbikëqyrjen rregullatore të veprimtarisë së licencuar.

- Për sa më sipër, si dhe në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procedurës administrative, Bordi çmon se janë plotësuar kushtet ligjore për miratimin e transferimit të licencës së tregtimit të energjisë elektrike nga shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k. tek shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e licencës nr. 438, seria T19/T23, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 7.3.2019, rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s



nr. 289, datë 9.10.2023, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, tek shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k.

2. Shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k., në cilësinë e mbajtësit të ri të licencës, ushtron veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në përputhje me kushtet e licencës së transferuar, legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore të miratuara nga ERE.

3. Transferimi i licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi nuk sjell ndryshim të kushteve, të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në licencën nr. 438, seria T19/T23, të cilat vijojnë të zbatohen nga subjekti përfitues i transferimit.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 183, datë 6.7.2026

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SHPK PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS SË FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TE SHOQËRIA “EZ5 TRADING” SHPK

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 13 dhe 17, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator

të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1613/7 prot., datë 3.7.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së tregtimit dhe asaj të furnizimit të energjisë elektrike te shoqëria ‘EZ5 Trading’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 439, seria F19/F23, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 39, datë 7.3.2019, si dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 288, datë 9.10.2023, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1614 prot., datë 18.5.2026, shoqëria, në cilësinë e subjektit mbajtës të licencës ka depozituar aplikimet për transferimin e plotë të licencës së furnizimit të energjisë elektrike, tek shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k., e cila do të administrojë dhe operojë këtë veprimtari.

- Në mbështetje të kësaj kërkesë dhe pas verifikimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 154, datë 28.5.2026, vendosi të fillojë procedurën për transferimin e licencës së furnizimit të shoqërisë.

- Në zbatim të kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.5.2026 dhe 1.6.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 8.6.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Brenda afatit të përcaktuar për paraqitjen e komenteve apo kundërshtimeve nga palët e interesuara nuk u administruan komente apo objeksione, lidhur me kërkesën objekt shqyrtimi, çka evidenton mungesën e pretendimeve nga palët e treta mbi procedurën e nisur.

- Në vijim të shqyrtimit të aplikimit, ERE konstatoi nevojën për plotësimin e dokumentacionit



të paraqitur dhe me shkresën nr. 1613/3 prot., datë 11.6.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së transferimit të licencës, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikim.

- Në përgjigje të kësaj kërke, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1613/4 prot., datë 16.6.2026, shoqëria depozitoi dokumentacion plotësues, nga analizimi i të cilit rezultoi se kishte ende dokumentacion që nevojitej të plotësohej, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë nëpërmjet shkresës me nr. 1613/5 prot., datë 24.6.2026.

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1613/6 prot., datë 30.6.2026, shoqëria depozitoi informacionin/dokumentacion e kërkuar, duke plotësuar dokumentacionin administrativ të nevojshëm për përfundimin e shqyrtimit të kërkesës.

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës administrative rezulton se kërkesa e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. për transferimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike është paraqitur në përputhje me kërkesat procedurale të përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, ku në përputhje me nenin 17, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave “a”, “b”, “c”, “d” dhe “f”.

- Në zbatim të nenit 17 të kësaj rregulloreje, aplikuesi ka depozituar dokumentacionin e kërkuar për procedurën e transferimit të licencës, ndërsa gjatë shqyrtimit administrativ ka plotësuar edhe dokumentacionin shtesë të kërkuar nga ERE, duke mundur administrimin e plotë të dosjes së aplikimit.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nuk rezultojnë mospërputhje me kërkesat e legjislacionit sektorial apo mangësi të tilla që të përbëjnë pengesë për vijimin dhe përfundimin e procedurës së transferimit të licencës.

- Rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe

heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Po ashtu, rezulton se shoqëria ka shlyer dhe pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Po ashtu, në përfundim të procedurës së njoftimit publik të fillimit të procedurës administrative nuk u administruan komente, kundërshtime apo pretendime nga palë të treta, të cilat të kërkonin verifikime shtesë ose të evidentonin rrethana që do të ndikonin në vlerësimin e kërkesës.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës administrative rezulton se janë përmbushur kërkesat ligjore dhe procedurale për shqyrtimin e kërkesës për transferimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike nga shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k. tek shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k.

- Procedura objekt shqyrtimi nuk përbën dhënie të një licence të re, por transferimin e një licence ekzistuese, në përputhje me nenin 44, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenin 17, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Për rrjedhojë, objekt i shqyrtimit të Bordit nuk është rivlerësimi i nevojës për licencimin e kësaj veprimtarie, por verifikimi i përmbushjes së kushteve ligjore për transferimin e cilësisë së mbajtësit të licencës.

- Nga analiza e dokumentacionit të administruar rezulton se shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, ndërsa gjatë procedurës administrative ka plotësuar edhe kërkesat e ERE-s për administrimin e dokumentacionit shtesë. Po ashtu, nuk rezultojnë rrethana ligjore ose procedurale që të përbëjnë pengesë për miratimin e transferimit të licencës.

- Bordi konstaton, gjithashtu, se gjatë procedurës së njoftimit publik, nuk janë paraqitur komente apo kundërshtime nga palë të treta, ndërsa nga verifikimet e kryera nuk rezultojnë detyrime të papërmbushura ndaj ERE-s që do të ndikonin në përfundimin e procedurës.

- Në vlerësim të dokumentacionit të administruar, Bordi çmon se transferimi i licencës nuk sjell ndryshim të objektit, përmbajtjes apo kushteve të licencës së miratuar, por vetëm ndryshimin e subjektit mbajtës të saj. Për rrjedhojë, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga



licenca nr. 439, seria F19/F23, vijnë të ushtrohen dhe të përmbushen nga subjekti përfitues i transferimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e licencës së transferuar.

- Po kështu, Bordi vlerëson se miratimi i transferimit të licencës nuk cenon funksionimin normal të tregut të energjisë elektrike, nuk ndikon në ushtrimin e kompetencave rregullatore të ERE-s dhe nuk krijon rrethana që të pengojnë mbikëqyrjen rregullatore të veprimtarisë së licencuar.

- Për sa më sipër, si dhe në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procedurës administrative, Bordi çmon se janë plotësuar kushtet ligjore për miratimin e transferimit të licencës së furnizimit të energjisë elektrike nga shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k. tek shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e licencës nr. 439, seria F19/F23, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 39, datë 7.3.2019, si dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 288, datë 9.10.2023, të shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k.

2. Shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k., në cilësinë e mbajtësit të ri të licencës, ushtron veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, në përputhje me kushtet e licencës së transferuar, legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore të miratuara nga ERE.

3. Transferimi i licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi nuk sjell ndryshim të kushteve, të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në licencën nr. 439, seria F19/F23, të cilat vijnë të zbatohen nga subjekti përfitues i transferimit.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,

brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 184, datë 6.7.2026

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “NEXORA ENERGY” SHPK PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1660/7 prot., datë 3.7.2026, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Nexora Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Nexora Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1660 prot., datë 22.5.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Pas verifikimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 160, datë 5.6.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- Në zbatim të kërkesave të Rregullores së Licencimit, ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat



6.6.2026 dhe 8.6.2026). Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Brenda afatit të përcaktuar nuk u administruan komente apo kundërshtime nga palët e interesuara, të cilat të kërkonin kryerjen e verifikimeve shtesë apo të ndikonin në vijimin e procedurës administrative.

- ERE, me shkresën nr. 1660/3 prot., datë 10.6.2026, e ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për licencimin e saj, si dhe i ka bërë me dije se në rast licencimi, do t'i lihet kushti përkatës, në lidhje me përditësimin e informacionit mbi stafin teknik.

- Në vijim të procedurës, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1660/4 prot., datë 22.6.2026, shoqëria ka depozituar informacion plotësues, nga shqyrtimi i të cilit është vlerësuar i nevojshëm zhvillimi i komunikimit të mëtejshëm. Ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1660/5 prot., datë 24.6.2026, në lidhje me sqarimet përkatëse për stafin teknik që do të ushtrojë veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1660/6 prot., datë 30.6.2026, shoqëria depozitoi informacionin e kërkuar, duke plotësuar dokumentacionin administrativ të nevojshëm për përfundimin e shqyrtimit të aplikimit.

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Përputhshmëria e aplikimit me kuadrin ligjor dhe rregullator

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës administrative rezulton se kërkesa e shoqërisë “Nexora Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike është paraqitur në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe me kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Në përfundim të shqyrtimit administrativ rezulton se shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, ndërsa gjatë procedurës është informuar edhe për dokumentacionin dhe sqarimet shtesë të kërkuara nga ERE, duke plotësuar dosjen e aplikimit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

- Rezulton, gjithashtu, se aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit në përputhje me kërkesat e rregullores së licencimit dhe nuk rezultojnë detyrime financiare ndaj Entit Rregullator të Energjisë që të përbëjnë pengesë për përfundimin e procedurës së licencimit.

- Po ashtu, në përfundim të procedurës së njoftimit publik për fillimin e procedurës administrative nuk u administruan komente, kundërshtime apo pretendime nga palë të treta, të cilat të kërkonin verifikime të mëtejshme ose të ndikonin në shqyrtimin e kërkesës.

- Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar nuk rezultojnë pengesa ligjore apo procedurale që të ndalojnë licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Nexora Energy” sh.p.k. për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës, të njoftojë shoqërinë “Nexora Energy” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 185, datë 6.7.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E
SHOQËRISË “KORPORATA
ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE
(KESH)” SHA PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TEC-et
LUNDRUESE “TIGRI 1”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw DHE
“TIGRI 3”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 60 mw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1950/1 prot., datë 3.7.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Korporata Elektroenergjetike Shqiptare’ sh.a. (KESH sh.a.) për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et lundruese ‘Tigri 1’, me kapacitet të instaluar 50 mw dhe ‘Tigri 3’, me kapacitet të instaluar 60 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a.” (KESH sh.a.), me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1950 prot., datë 23.6.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et lundruese “Tigri 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw dhe “Tigri 3”, me kapacitet të instaluar 60 mw, me vendndodhje në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës.

- Nga verifikimi paraprak i aplikimit rezulton se shoqëria ka aktualisht një licencë të vlefshme deri në

datën 22.8.2026, dhe ka paraqitur dokumentacionin bazë të kërkuar për fillimin e procedurës administrative dhe, gjithashtu, shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të rregullores, rezulton se aplikimi duhet të plotësohet me dokumentacionin dhe sqarime të mëtjshme, në përputhje me kërkesat e rregullores së licencimit, përpara se Bordi të shprehet përfundimisht mbi kërkesën.

Shqyrtimi paraprak i aplikimit

- Në mbështetje të nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, u krye verifikimi paraprak i kërkesës dhe dokumentacionit të depozituar nga shoqëria “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH)” sh.a.

- Nga shqyrtimi paraprak rezulton se aplikimi është paraqitur në formatin e kërkuar nga rregullorja e licencimit dhe është shoqëruar me dokumentacionin bazë të nevojshëm për fillimin e procedurës administrative.

- Gjatë këtij verifikimi u konstatua se, në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “c” dhe “d”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germës “a”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera
Rezulton se shoqëria “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. (KESH sh.a.)”

- Ka depozituar kontratën “Bareboat” dhe marrëveshjen e shërbimeve O&M, me nr. 1660/1 prot., datë 4.4.2022, nënshkruar ndërmjet KESH sh.a., në cilësinë e kompanisë dhe shoqërive “Exelerate Global Operations” L.L.C, si pronar i parë dhe “Renco” S.P.A., si ofrues i parë i



shërbimeve, së bashku me amendamentin 1 me nr. 1660/7 prot., datë 7.4.2022.

- Ka nënshkruar më herët, në datën 17.3.2023, marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit të dy njësjive gjeneruese termike (TEC) lundruese, me shoqërinë “Operatori Sistemit Transmetimit” (OST) sh.a.

- Është pajisur me lejen për përdorim burimi ujor sipërfaqësor me nr. serie 000047, nr. 5/7 prot., datë 15.3.2023, të miratuar me vendimin nr. 3, datë 13.3.2023, të Këshillit të Basenit Ujor Vjosë.

- Është pajisur me aktin e miratimit *e-Leje* mjedisi tipi A, me nr. 1665 prot., datë 3.3.2023, me titull “Industritë Energetike, trajtimi i ujërave dhe ujërave të zeza”, për të zhvilluar projektin ID 1.1 Instalimet me dëgjie. ID 6.1 Instalim trajtimi për ujëra të ndotura urbane. ID 6.2 Trajtimi i ujërave të ndotura industriale në vendin ku krijohen. Kapaciteti i projektuar është 110 mw”, me vendndodhje qarku Vlorë, Bashkia Vlorë, Njësia Administrative Qendër Vlorë, Nartë, Triport zona kadastrale 8604.

Në këtë aplikim shoqëria duhet të depozitojë dhe sa vijon:

Neni 9. Format dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2, Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: dëshminë e penalitetit, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për administratorin.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “b”: të sqarojë/saktësojë me shoqërinë, në lidhje me mbështetjen financiare për sa referuar në plan-biznesin e përgjithshëm dhe programin ekonomik, si dhe të depozitojë në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin dokumentet e depozituara në kuadër të kësaj pike;

- germa “c”: të depozitojë plan-biznesin e përgjithshëm të nënshkruar dhe/ose vulosur dhe të plotësojë këtë dokument me të gjitha sqarimet/konkluzionet dhe analizat që kanë të bëjnë me nevojën e operimit të këtij impianti për të gjithë periudhën e kërkuar për operim, si dhe parashikimet përkatëse në lidhje me jetëgjatësinë e licencës.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

- germa “a”: të plotësojë jetëgjatësinë e pritshme të centralit, afatin për të cilin kërkon licencimin dhe

të depozitojë dokumentacionin mbështetës për jetëgjatësinë e centralit;

germa “b”: autorizimin e organit shtetëror për ndërtimin/operimin e këtij centrali; të dokumentojë që të gjitha përcaktimet e kontratës janë përmbushur; dhe të informojë/dokumentojë modalitetet mbi bazën e të cilave do të bëhet kalimi i asetit në pronësi.

Po ashtu, duhet të depozitojë amendamentin me nr. 1660/7 prot., datë 7.4.2022, të përkthyer në gjuhën shqipe, si dhe kontratën në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin;

- germa “c”: të depozitojë marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a.;

- germa “d”: të depozitojë në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin lejen e ujit dhe vendimin e KBU Vjosë;

- germa “e”: të depozitojë në ERE kontratën e koncesionit nr. rep., 554, nr. kol. 203, datë 29.4.2022, si dhe dokumente të tjera që mund të afektojnë lejen e mjedisit apo këtë procedurë.

Po ashtu, vlerësohet që ERE t’i drejtohet dhe vetë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në lidhje me vlefshmërinë dhe zbatimin e kushteve të kësaj lejeje.

Nga analiza paraprake nuk rezultojnë rrethana që të pengojnë fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës, ndërsa vlerësimi mbi përmbushjen e të gjitha kushteve ligjore dhe rregullatore për licencim do të kryhet në përfundim të procedurës administrative, pas administrimit të dokumentacionit të plotë dhe analizës nga ERE.

Për sa më sipër, vlerësohet se janë plotësuar kushtet procedurale për fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Korporata Elektroenergetike Shqiptare sh.a. (KESH sh.a.)”, për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, nga TEC-et lundruese “Tigri 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw, dhe “Tigri 3”, me kapacitet të instaluar 60 mw, me vendndodhje në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës.

2. Shoqëria “Korporata Elektroenergetike Shqiptare (KESH)” sh.a., të depozitojë pranë ERE-s dokumentacionin dhe sqarimet shtesë të kërkuara



gjatë shqyrtimit të aplikimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. (KESH sh.a.)”, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit Transmetimit” (OST sh.a.) dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM Nr. 186, datë 6.7.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA” SHPK PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa

“a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1923/1 prot., datë 3.7.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Yildirim Energy Europe Albania’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, me afat vlefshmërie deri më 21.12.2026.

- Nga verifikimi paraprak i aplikimit rezulton se në momentin e licencimit shoqëria ka qenë identifikuar me emrin “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., emër të cilin e ka ndryshuar në vijim, në datën 28.9.2022, në “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k., gjë që është reflektuar dhe në rishikimin e vendimit në kuadër të plotësimit të kushteve.

- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1923 prot., datë 22.6.2026.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 496, seria F21, është 21.12.2026) dhe si e tillë aplikimi duhet të kryhej në datën 21.6.2026.

- Në nenin 56, pika 4, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se në rast se dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ndaj, duke qenë se afati i fundit (data 21.6.2026) ka qenë ditë e dielë, paraqitja e aplikimit në datën 22.6.2026, konsiderohet në afat sipas përcaktimeve të KPA-së. Nga sa konstatohet, shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të Rregullores.

- Rezulton se kërkesa për rinovim, shtojcat dhe deklaratat janë nënshkruar vetëm nga një prej administratorëve të shoqërisë. Referuar ekstraktit



historik, shoqëria ka dy administratorë që e përfaqësojnë atë vetëm bashkërisht, me nënshkrim të përbashkët. Sa rakorduar, rezulton se pagesa e aplikimit është bërë nga llogaria bankare e shoqërisë, si e tillë vlerësohet se ka një vullnet të shoqërisë për paraqitjen e aplikimit për rinovim. Gjithsesi, vlerësohet që t'i sqarohet shoqërisë se aktet duhet të depozitohen të nënshkruara sipas kompetencave të administratorëve të përcaktuara në ekstraktin e regjistrit tregtar të QKB-së.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit si dhe shoqëria ka paraqitur dokumentacionin bazë të kërkuar për fillimin e procedurës administrative.

- Për sa depozituar nga shoqëria dhe në referencë të përcaktimeve të rregullores, vlerësohet se aplikimi duhet të plotësohet me dokumentacionin dhe sqarime të mëtejshme, në përputhje me kërkesat e rregullores së licencimit, përpara se Bordi të shprehet përfundimisht mbi kërkesën. Në vijim aplikimi duhet të plotësohet dhe me dokumentacionin, si vijon:

- dëshmia e penalitetit për vetë shoqërinë dhe për administratorët e saj;

- vërtetimi i përditësuar, në lidhje me shlyerjen e detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- plani i biznesit;

- dokumentimi i disponimit të mbështetjes financiare për ushtrimin e veprimtarisë;

- informacion në lidhje me sistemin e IT-së për ushtrimin e aktivitetit të furnizimit;

- sqarime në lidhje me afatin e kontratës së qirasë së zyrave përfaqësuese të furnizimit.

Nga analiza paraprake nuk rezultojnë rrethana që të pengojnë fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës, ndërsa vlerësimi mbi përmbushjen e të gjitha kushteve ligjore dhe rregullatore për licencim do të kryhet në përfundim të procedurës administrative, pas administrimit të dokumentacionit të plotë dhe analizës nga ERE. Nga shqyrtimi paraprak rezulton se aplikimi është paraqitur në formatin e kërkuar nga rregullorja e licencimit dhe është shoqëruar me dokumentacionin

bazë të nevojshëm për fillimin e procedurës administrative.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 496, seria F21, të shoqërisë “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 187, datë 6.7.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E
SHOQËRISË “YILDIRIM ENERGY
EUROPE ALBANIA” SHPK PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e



Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1922/1 prot., datë 3.7.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Yldirim Energy Europe Albania’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2021, me afat vlefshmërie deri më 21.12.2026.

- Nga verifikimi paraprak i aplikimit rezultoi se në momentin e licencimit shoqëria ka qenë identifikuar me emrin “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., emër të cilin e ka ndryshuar në vijim, në datën 28.9.2022, në “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k., gjë që është reflektuar dhe në rishikimin e vendimit në kuadër të plotësimit të kushteve.

- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1922 prot., datë 22.6.2026.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 495, seria T21, është 21.12.2026) dhe si e tillë aplikimi duhet të kryhej në datën 21.6.2026.

- Në nenin 56, pika 4, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se në rast se dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ndaj, duke qenë se afati i fundit (data 21.6.2026) ka qenë ditë e diel, paraqitja e aplikimit në datën 22.6.2026, konsiderohet në afat sipas përcaktimeve të KPA-së. Nga sa konstatohet, shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të rregullores.

- Rezulton se kërkesa për rinovim, shtojcat dhe deklaratat janë nënshkruar vetëm nga një prej administratorëve të shoqërisë. Referuar ekstraktit historik, shoqëria ka dy administratorë që e përfaqësojnë atë vetëm bashkërisht, me nënshkrim të përbashkët. Sa rakorduar, rezultoi se pagesa e aplikimit është bërë nga llogaria bankare e shoqërisë, si e tillë vlerësohet se ka një vullnet të shoqërisë për paraqitjen e aplikimit për rinovim. Gjithsesi, vlerësohet që t’i sqarohet shoqërisë se aktet duhet të depozitohen të nënshkruara sipas kompetencave të administratorëve të përcaktuara në ekstraktin e regjistrimit tregtar të QKB-së.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezultoi se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit si dhe shoqëria ka paraqitur dokumentacionin bazë të kërkuar për fillimin e procedurës administrative.

- Për sa depozituar nga shoqëria dhe në referencë të përcaktimeve të rregullores, vlerësohet se aplikimi duhet të plotësohet me dokumentacionin dhe sqarime të mëtejshme, në përputhje me kërkesat e rregullores së licencimit, përpara se Bordi të shprehet përfundimisht mbi kërkesën. Në vijim aplikimi duhet të plotësohet dhe me dokumentacionin si vijon:

- dëshmia e penalitetit për vetë shoqërinë dhe për administratorët e saj;

- vërtetimi i përditësuar, në lidhje me shlyerjen e detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- plani i biznesit;

- dokumentimi i disponimit të mbështetjes financiare për ushtrimin e veprimtarisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 495, seria T21, të shoqërisë “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k., për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë



“Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 188, datë 13.7.2026

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN QERSHOR 2026, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2025/1 prot., datë 8.7.2026, të për gatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

I. Aspektet ligjore dhe procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga FSHU sh.a.

Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën nr. 4232 prot., datë 29.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 2025 prot., datë 3.7.2026, ka depozituar kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin qershor 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar.

II. Analiza e përlllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin qershor 2026, FSHU sh.a. ka siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh përmes blerjeve ditore/mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX), duke u bazuar në profilet ditore të prokuruar, çmimet ditore/orare dhe vlerat përkatëse të faturuara.

2. Përlllogaritja e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes (ÇBEt)

Bazuar në të dhënat e paraqitura, FSHU sh.a. ka përlllogaritur çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për muajin qershor 2026, në vlerën 9.20 lekë/kwh. Kjo vlerë është verifikuar edhe nga ERE, nëpërmjet një rillogaritjeje, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 9.20 lekë/kwh, në përputhje me përlllogaritjet e paraqitura nga shoqëria.

3. Komponentët sipas metodologjisë (neni 8, vendimi nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përlllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë, si më poshtë:

- Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) për muajin qershor 2026: 9.20 lekë/kwh;



- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025–31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 279, datë 16.12.2024: 0.85 lekë/kwh;

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të Bordit të ERE nr. 103, datë 14.4.2026, “Mbi përcaktimin e tarifave të përkohshme të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit për periudhën 1 maj 2026–31 dhjetor 2026, është 1.55 lekë/kwh.

- Kostot administrative: 1.06 lekë/kwh;

- Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro), për çdo datë respektive në harkun kohor 29.5.2026–29.6.2026.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2026, përlllogarit, si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin qershor 2026		
	Njësia	Çmimi
CBEt Çminimesatar i pondëuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	9.20
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.28
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA	Lekë/kWh	12.94

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit rezulton 12.94 lekë/kwh për muajin qershor 2026.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2026 prej 12.94 lekë/kwh, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategorinë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data

e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM Nr. 189, datë 13.7.2026

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “ç” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 13, 14, pikat 9 dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për



dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1564/6 prot., datë 9.7.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘AlbEsp Trading & Consulting’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 241, datë 2.12.2021, me afat vlefshmërie deri më 2.12.2026.

- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1564/1 prot., datë 26.5.2026.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 492, seria F21, është 2.12.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 2.6.2026.

- Sa konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të rregullores.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 169, datë 15.6.2026, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.6.2026 dhe 17.6.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.6.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1564/4 prot., datë 17.6.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës, si dhe i ka bërë me dije, në lidhje me

informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikim.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1564/5 prot., datë 26.6.2026, ka depozituar informacionin/dokumentacionin e kërkuar.

- Rezulton se shoqëria ka aktualisht një kontratë të vlefshme për disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit, por duke qenë se afati i saj përfundon më 1.11.2026 dhe nuk mbulon të gjithë periudhën 5-vjeçare të vlefshmërisë së licencës, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që brenda kësaj date të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar, ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Për sa më sipër, vlerësohet se janë plotësuar kushtet ligjore dhe rregullatore për rinovimin e licencës së shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me kushtin e sipërcituar, lidhur me dokumentimin e disponimit të zyrave përfaqësuese.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 492, seria F21, të shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 241, datë 2.12.2021, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar), me efekt nga data 3.12.2026.

2. Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., jo më vonë se data 1.11.2026, të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument, në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të vlefshmërisë së licencës.

3. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 në përputhje me legjislacionin në fuqi.



4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 190, datë 13.7.2026

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, 13 dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1565/6 prot., datë 9.7.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘AlbEsp Trading & Consulting’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 2.12.2021, me afat vlefshmërie deri më 2.12.2026.

- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1565/1 prot., datë 26.5.2026.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 493, seria T21, është 2.12.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 2.6.2026.

- Sa konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të rregullores.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 170, datë 15.6.2026, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.6.2026 dhe 17.6.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.6.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1564/4 prot., datë 17.6.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës, si dhe i ka bërë me dije, në lidhje me informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikim.

- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1565/4 prot., datë 26.6.2026, ka depozituar informacionin/dokumentacionin e kërkuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në këtë procedurë, vlerësohet se janë



plotësuar kushtet ligjore dhe rregullatore për rinovimin e licencës së shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 493, seria T21, të shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 2.12.2021, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar), me efekt nga data 3.12.2026.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 191, datë 13.7.2026

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE- s, LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DOMA GROUP” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për

dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1721/8 prot., datë 10.7.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Doma Group’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Doma Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1721 prot., datë 1.6.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Vinjolli 1”, me vendndodhje në përroin e Varroshit, Manadresë dhe Lajthit, degë e përroit të Zallit të Madh, Bashkia Mat, qarku Dibër.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 167, datë 15.6.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.6.2026 dhe 17.6.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.6.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 1721/4 prot., datë 18.6.2026, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur ndonjë qëndrim, në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë.

- Me shkresën nr. 1721/3 prot., datë 18.6.2026 dhe *email-in* e datës 9.7.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës, si dhe i ka bërë me dije, në lidhje me informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikim.



- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1721/5 prot., datë 29.6.2026 dhe *email-in* e datës 9.7.2026, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues të aplikimit, nga shqyrtimi i të cilit rezultoi se ka nevojë të plotësohet dokumentacioni për mbështetjen financiare sipas vlerës së investimit që rezultoi nga kontrata e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Zgjatja e vendimmarrjes

- Në nenin 14, pika 3, parashikohet se: “Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.”.

- Për gjithë sa më sipër, me qëllim për të zhvilluar korrespondencën vijuese me shoqërinë, vlerësohet zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes së Bordit mbi kërkesën e shoqërisë “Doma Group” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Vinjoli 1”, me vendndodhje në përroin e Varroshit, Manadresë dhe Lajthit, degë e përroit të Zallit të Madh, Bashkia Mat, qarku Dibër. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e mbështetjes financiare brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Doma Group” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Vinjoli 1”, me vendndodhje në përroin e Varroshit, Manadresë dhe Lajthit, degë e përroit të Zallit të Madh, Bashkia Mat, qarku Dibër.

2. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e mbështetjes financiare brenda 20 (njëzet) ditëve.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Doma Group” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 192, datë 13.7.2026

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE- S LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “GLOBAL INTERPRISE GROUP” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1722/7 prot., datë 10.7.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Global Interprise Group’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Global Interprise Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1722 prot., datë 1.6.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Doma”, me kapacitet të instaluar 1.695 mw, me vendndodhje në përroin e Lusës, degë e Lumit Mat, Bashkia Klos, qarku Dibër.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 168, datë 15.6.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.6.2026 dhe 17.6.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.6.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.



- ERE po ashtu ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 1722/4 prot., datë 18.6.2026, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur ndonjë qëndrim, në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë.

- Me shkresën nr. 1722/3 prot., datë 18.6.2026 dhe *email-in* e datës 9.7.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës, si dhe i ka bërë me dije në lidhje me informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1722/5 prot., datë 29.6.2026, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues, nga shqyrtimi i të cilit rezulton se ka nevojë të plotësohet dokumentacioni për mbështetjen financiare sipas vlerës së investimit që rezulton nga llogaritja e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Zgjatja e vendimmarrjes

- Në nenin 14, pika 3, parashikohet se: “Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.”.

- Për gjithë sa më sipër, me qëllim për të zhvilluar korrespondencën vijuese me shoqërinë, vlerësohet zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes së Bordit mbi kërkesën e shoqërisë “Global Interprise Group” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Doma”, me kapacitet të instaluar 1.695 mw, me vendndodhje në përroin e Lusës, degë e Lumit Mat, Bashkia Klos, qarku Dibër. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e mbështetjes financiare brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Global Interprise Group” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë

elektrike nga HEC “Doma”, me kapacitet të instaluar 1.695 mw, me vendndodhje në përroin e Lusës, degë e Lumit Mat, Bashkia Klos, qarku Dibër.

2. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e mbështetjes financiare brenda 20 (njëzet) ditëve.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Global Interprise Group” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 193, datë 13.7.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E
SHOQËRISË “GERTI” SHPK, PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2015/2 prot., datë 10.7.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Gerti’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2015 prot., datë



2.7.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltai, me kapacitet të instaluar 10 mw, duke përfshirë dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, me vendndodhje në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër.

- Në lidhje me sa kërkuar nga shoqëria, për përfshirjen e veprave ndihmëse, sqarojmë se në shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, protokolluar me tonën nr. 1291/8 prot., datë 1.7.2026, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka sjellë në vëmendje të ERE-s, se referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë dhe shtimin e veprave ndihmëse apo njërive të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi.

- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet që për sa kërkuar nga shoqëria për të përfshirë në licencën e prodhimit dhe veprat ndihmëse, t'i kërkohej MIE-s qëndrimi/vlerësimi i saj. Po ashtu, vetë ERE do të njoftojë MIE-n për këtë procedurë.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se:

Shqyrtimi paraprak i aplikimit

- Në mbështetje të nenit 10, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", u krye verifikimi paraprak i kërkesës dhe dokumentacionit të depozituar nga shoqëria.

- Nga shqyrtimi paraprak rezulton se aplikimi është paraqitur në formatin e kërkuar nga rregullorja e licencimit dhe është shoqëruar me dokumentacionin bazë të nevojshëm për fillimin e procedurës administrative.

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave "a", "b" dhe "c", duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave "a", "c" dhe "d".

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave "a" dhe "c".

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave "b", "c", "d" dhe "f".

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera Shoqëria "Gerti" sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në datën 10.2.2026, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 10 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër, nga shoqëria "Gerti" sh.p.k.";

- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) nr. 3502/3 prot., datë 17.4.2024, me lëndë "Miratim pikë lidhje për central fotovoltai",

- Është pajisur me VNM paraprake, lëshuar më 18.3.2026, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit "Ndërtimi i Parkut Fotovoltai Murati, 10 mw".

- Rezulton se shoqëria duhet të plotësojë këtë aplikim dhe me dokumentacionin si vijon:

NENI 9. Formatin dhe dokumentacionin për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2, Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa "b": dëshminë e penalitetit për administratorin tjetër të saj.

Pika 1.3, Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa "b": dokumentacionin mbështetës që vërteton se ka aftësi financiare për të mbuluar 100% të vlerës totale të investimit të projektit sipas modalitetit të parashikuar në planin e biznesit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:



- germa “a”: garancinë për panelet, në rast se e disponon një të tillë, për të rakorduar afatin e vlefshmërisë së licencës, si dhe të përcaktojë një datë specifike në të cilën parashikon të fillojë operimin e centralit;

- germa “e”: informacion, në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit.

- Nga analiza paraprake nuk rezultojnë rrethana që të pengojnë fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës, ndërsa vlerësimi mbi përmbushjen e të gjitha kushteve ligjore dhe rregullatore për licencim do të kryhet në përfundim të procedurës administrative, pas administrimit të dokumentacionit të plotë dhe analizës nga ERE.

- Për sa më sipër, vlerësohet se janë plotësuar kushtet procedurale për fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k. për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltai, me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër.

2. Shoqëria “Gerti” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacionin dhe sqarimet shtesë të kërkuara gjatë shqyrtimit të aplikimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Gerti” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,

brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 194, datë 13.7.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “GERTI” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2015/1 prot., datë 10.7.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Gerti’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 990 prot., datë 26.3.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 9, pika 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; pika 1.2, germat: “a” “c” dhe “d”; pika 1.3, germa “a”.



- Rezulton se shoqëria duhet të plotësojë këtë aplikim dhe me sa vijon:

Neni 9. Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: dëshminë e penalitetit për administratorin tjetër të saj.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “b”: informacion mbi sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë për 5 vitet e ardhme të ushtrimit të aktivitetit, përlogaritjen për vlerën që nevojitet për të garantuar ushtrimin e veprimtarisë për të paktën 1 (një) muaj dhe mbështetjen financiare;

- germa “c”: planin e biznesit për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga analiza paraprake nuk rezultojnë rrethana që të pengojnë fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës, ndërsa vlerësimi mbi përmbushjen e të gjitha kushteve ligjore dhe rregullore për licencim do të kryhet në përfundim të procedurës administrative, pas administrimit të dokumentacionit të plotë dhe analizës nga ERE.

- Për sa më sipër, vlerësohet se janë plotësuar kushtet procedurale për fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k. për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Shoqëria “Gerti” sh.p.k., të depozitojë në ERE dokumentacionin dhe sqarimet shtesë të kërkuara gjatë shqyrtimit të aplikimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Gerti” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të

Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 195, datë 13.7.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “IDI 2005” SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET BARRËSIMIT) E ASETEVE FIKSE TË SAJ SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SHA

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, germa “b”, neneve 6, 7 dhe 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 1.3 dhe pikës 1.6, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1959/1 prot., datë 10.7.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për barrësimin e aseteve fikse të saj, në favor të ‘Intesa SanPaolo Bank Albania’ sh.a.”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:



1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 30, datë 27.03.2024, nga HEC “Arcovë” me kapacitet të instaluar 1.28 mw, me vendndodhje Përroi i Arçovës, degë e përroit të Selcës dhe Holtës me derdhje në lumin Shkumbin, qarku Elbasan.

- Me shkresën nr. 1959 prot., datë 25.6.2026, shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve të HEC “Arcovë”, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të neneve 2, germa “a”, 3, 5, germa “j” dhe 6 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licencuarve për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Neni 7, Pika 1

- germa “a”: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE ekstraktin historik të shoqërisë tregtare;

- germa “c”: Shoqëria duhet të bëjë me dije në lidhje me gjendjen financiare aktuale të saj dhe efektin që parashikon pas miratimit të transferimit të aseteve;

- germa “d”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion, në lidhje me kandidatin e propozuar për transferimin e aseteve (Intesa SanPaolo Bank Albania sh.a.);

- germa “h”: Shoqëria duhet të depozitojë kontratën e hipotekës dhe/ose marrëveshjen sigurorese, së bashku me listën e detajuar të aseteve dhe vlerat përkatëse. Po ashtu, vlerësohet t’i kërkohej shoqërisë të bëjë me dije, lidhur me statusin e zbatimit/disbursimit të kësaj kontrate;

- germa “i”: Shoqëria duhet të paraqesë në ERE deklaratën e bankës, ku të shprehet gatishmëria e saj

që të garantojë vetë/me palë të tjera veprimtarinë e licencuar në rast të transferimit të aseteve;

- germa “j”: Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka listë transferimesh të kryera më herët prej saj;

- pika 3: Shoqëria duhet të bëjë me dije në rast se i është drejtuar MIE-s, në lidhje me këtë procedurë;

- pika 6: Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të përcjellë që kërkon të mos jetë e hapur për publikun.

- Nga analiza paraprake nuk rezultojnë rrethana që të pengojnë fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës, ndërsa vlerësimi mbi përmbushjen e të gjitha kushteve ligjore dhe rregullatore do të kryhet në përfundim të procedurës administrative, pas administrimit të dokumentacionit të plotë dhe analizës nga ERE.

- Për sa më sipër, vlerësohet se janë plotësuar kushtet procedurale për fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a. (referuar kontratës së kredisë nr. 4995 rep., nr. 3372 kol., datë 30.8.2025).

2. Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacionin dhe sqarimet shtesë të kërkuara gjatë shqyrtimit të aplikimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të



bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 196, datë 13.7.2026

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 91, DATË
2.4.2026, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘DION ENERGJI’ SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1693/4 prot., datë 9.7.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 91, datë 2.4.2026, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘DION Energji’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw”, i ndryshuar, konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 91, datë 2.4.2026, i ndryshuar me vendimin nr. 152, datë 28.5.2026, vendosi të licencojë shoqërinë “Dion Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

- Në pikën 3 të këtij vendimi përcaktohet se shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i operimit.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1693/3 prot., datë 30.6.2026, shoqëria ka depozituar të gjithë praktikën e ndjekur dhe dokumentacionin përkatës, në lidhje me testimin e veprës, sikurse përcaktuar në nenin 10 të kontratës nr. 1980 rep., nr. 1272 kol., datë 6.4.2023, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Me depozitimin e dokumentacionit përkatës të testimit të veprës brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 91/2026, i ndryshuar, vlerësohet se kushti i vendosur në pikën 3 të këtij vendimi është plotësuar, ndaj duhet të shfuqizohet.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

- Në vijim të shfuqizimit të pikës 3, të vendimit nr. 91/2026, i ndryshuar, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 4 të këtij vendimi, si vijon: “Ky vendim është objekt rishikimi në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 91, datë 2.4.2026, të ndryshuar, si vijon:

a) Pika 3 e vendimi të Bordit nr. 91, datë 2.4.2026, të ndryshuar, shfuqizohet;

b) Pika 4 e vendimi të Bordit nr. 91, datë 2.4.2026, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës të njoftojë shoqërinë “Dion Energji” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), OSSH sh.a., FTL sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

KËRKESË Nr. 535/13, datë 23.7.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit ‘Rikonstruksion i rrugëve në qytet, për rrugën, ‘Çel Islami’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Durrës.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për

pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të përllogaritur për pasuritë e llojit “truall”, bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat fizikë ose juridikë që preken nga realizimi i këtij projekti, emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar, si dhe personat fizikë ose juridikë, të cilët preken, por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si dhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Durrës, si dhe në Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 473,320.05 lekë (katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzet pikë zero pesë) lekë, përllogaritur bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘RIKONSTRUKSION I RRUGËVE NË QYTET, PËR RRUGËN ‘ÇEL ISLAMI’”, BASHKIA DURRËS

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekore (sipas kartelës së pasurisë)												Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqe (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	
1	Shtet			Durrës	8512	28/89	Truall	187.86	187.86		20	223	14.06	19,155.00	-	Regj. nr. I.N. 10.2003, datë 19.10.2003. Nr. regj. 5432, datë 21.1.2004, pasuria është e okupuar nga Musa Tahir Bllaka.
2	Shtet			Durrës	8512	28/92	Truall	183.49	183.49		20	225	14.47	19,155.00	-	Regj. nr. I.N. 10.2003, datë 19.10.2003. Nr. Regj. 5432, datë 28.1.2004, pasuria është e okupuar nga Ajim Selim Lumi.
3	Shtet			Durrës	8512	28/303	Truall	340.91	340.91		49	40	3.60	19,155.00	-	Regj. nr. 13320, datë 7.6.2012.
4	Shtet			Durrës	8512	28/311	Truall	304.17	304.17		49	196	133.75	19,155.00	-	Regj. nr. 13674, datë 14.9.2012.
5	Shtet			Durrës	8512	28/423	Truall	141.44	141.44		78	69	59.72	19,155.00	-	Regj. nr. 30923, datë 19.3.2026. Regj. bashkim ose ndarje pasurisë së paluajtshme, nr. APL- 10784, datë 10.2.2026. Nr. regj. 5432, datë 28.1.2004, pasuria është e okupuar nga Kujtim Jangozi.
6	Skender Arben	Maxhaku Maxhaku		Durrës	8512	28/187	Truall	210.00	210.00		39	82	15.30	19,155.00	293,071.50	Regj. nr. 8457, datë 8.12.2006. Vizion nga vol. 18, 39 f. 237,35
7	Shkëlqim Naim	Maxhaku Maxhaku		Durrës	8512	28/312	Truall	500.00	500.00	178.00	49	197	9.41	19,155.00	180,248.55	Regj. nr. 13676, datë 14.9.2012. Godinë bujari 3-katëshe. Vizion nga vol. 49, f. 193, 195 sip. e kati përfaqë 178 m², sip. e kati të parë 191.2 m², sip. e kati të dytë 200.3 m².
SHUMA PARAPRAKE															473,320.05	

**KËRKESË****Nr. 778/9, datë 20.7.2026****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Sistemim, asfaltim e masa inxhinierike në km 21+050-22+050, në rrugën ‘Qafëthanë–Lin–Pogradec’”, ndryshuar me VKM-në nr. 429, datë 26.6.2024.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “vresht” bazuar në udhëzim nr. 1, datë 5.10.2000, “Për kriteret teknike të përlogaritjes së vlerës së bimëve drufrutore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur

mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,321,713.00 (një milion e treqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e trembëdhjetë lekë, me efekt financiar shtesë 1,195,953.00 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntë qind e pesëdhjetë e tre lekë).

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 866, DATË 27.12.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘SISTEMIM, ASFALTIM E MASA INXHINIERIKE NË KM 21+050-22+050, NË RRUGËN ‘QAFËTHANË–LIN–POGRADEC’”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Të dhënat kadastrale				Vlerësimi për shpronësim			Vlera kulturore drufrutore	Vlera e objektit (lekë)	Sipërfaqja e objektit (m²)	Vlera totale (lekë)	Shënime
				Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sip. totale m²	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja e shpronësuar m²	Çmimi lekë/m²	Vlera (lekë)					
16	Vangjo	Jovan	Gjika	8582	20/105	1,270.00	Vresht	655	192	125,760.00	1,195,953.00			1,321,713.00	Konfirmuar nga ASHK-ja.
Vlera paraprake															
Efekti financiar shtesë											1,195,953.00			1,195,953.00	



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 288 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË][Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare][Viti: 2026 - Numri: 164][Datë: 29.07.2026 14:48:22 +02:00][b1f0ca88e-9f14-4e1c-a7ab-17db1987261c]

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e Botimeve Zyrtare)